

1 E martë, 14 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes  
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 15.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]. Znj.

8 Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar  
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i  
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep  
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Sot do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit të  
15 Prokurorisë 04448.

16 Vërej se z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Selimi janë të  
17 pranishëm në sallën e gjyqit, ndërkohë që z. Krasniqi e ndjekë  
18 seancën përmes videolidhjes.

19 Për procesverbal, dëshiroj të them që Dëshmitari 04448 do  
20 të japë dëshmi përmes videolidhjes, siç është lejuar nga Trupi  
21 Gjykues në parashtrimin e protokolluar F01851 dhe, sikurse e  
22 dini, sot dhe nesër, do zgjasë seanca nga ora 3.00 pasdite  
23 deri në 7.30 pasdite, do të bëjmë ndërkohë një pushim prej 30  
24 minutash nga ora 5.00 deri në orën 5.30.

25 Dua që paraprakisht të falënderoj palët, pjesëmarrësit,

1 sekretarët, stenografët, personelin e sigurisë, përkthyesit,  
2 personelin audiovizual për të gjithë bashkëpunimin e tyre për  
3 këtë seancë të pasdites sot dhe nesër.

4 Jemi në seancë të hapur.

5 Znj. Sekretare, ju lutem vazhdoni.

6 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes  
7 videolidhjes]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,  
9 Dëshmitar. Më dëgjoni?

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përmes videolidhjes] [Përkthim]  
11 Të nderuar Gjykatës, për procesverbal dëshiroj të them që në  
12 vendin e largët i pranishëm përveç dëshmitarit që është  
13 Dëshmitari 04448, jam dhe unë, Sekretare e Seancës.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do  
15 ju japin deklaratën solemne të cilën do të duhet që ta lexoni  
16 në pajtim me Rregulloren dhe rregullën a 141(2). Ju lutem  
17 shikojeni dokumentin dhe lexojeni me zë betimin solemn të  
18 dëshmitarit.

19 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Deklaroj  
20 solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe  
21 vetëm të vërtetës dhe se nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për  
22 të cilën kam dijeni.

23 DËSHMITARI: W04448

24 [Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

25 [Dëshmitari dëshmon përmes përkthimit]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit  
2 shumë.

3 Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, e cila  
4 planifikohet që të zgjasë mesatarisht dy ditë.

5 Sikurse mund ta dini, e para që do t'ju bëjë pyetje  
6 Prokuroria. Pasi të përfundojë Prokuroria, Ekipet e Mbrojtjes  
7 kanë të drejtë që t'ju bëjnë pyetje. Gjithashtu edhe anëtarët  
8 e Trupit Gjykues mund të lejojnë pyetje plotësuese në qoftë se  
9 përmbushen kriteret përkatëse. Dhe anëtarët e Trupit Gjykues  
10 mund të kenë pyetje për ju.

11 Dëshmitar, ju lutem mundohuni t'i jepni përgjigje  
12 pyetjeve qartë me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni  
13 pyetjen, lirisht mund t'i thoni Avokatit që shpreh ndryshe  
14 pyetjen ose ta shpjegojë atë në një mënyrë që është e kuptimtë  
15 për ju.

16 Po ashtu, ju lutem na thoni se cila është baza e  
17 njohurive, fakteve dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni.

18 Nëse do të pyeteni nga ZPS-ja që të konfirmoni disa  
19 korrigjime që keni bërë në deklaratën tuaj të më mëparshme, ju  
20 kërkoheni që të konfirmoni, për procesverbal, që deklaratat e  
21 mëparshme së bashku me korrigjimet, të pasqyrojnë me saktësi  
22 deklaratën përpara Trupit Gjykues.

23 Ju lutem flisni përpara mikrofonit. Bëni një pauzë prej  
24 pesë sekondash dhe flisni me ritëm të ndaltë për t'ju kapur  
25 përkthyesit.

1 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi përpara Trupit  
2 Gjykues, nuk lejohet që të flisni me askënd lidhur me  
3 përmbajtjen e dëshmisë suaj jashtë kësaj salle gjyqit. Në  
4 qoftë se ka ndonjë person jashtë sallës së gjyqit që ju kërkon  
5 pyetje, ju bën pyetje lidhur me dëshminë, ju lutem na e bëni  
6 me dije këtë gjë.

7 Gjithashtu, nëse, ju kërkoj që të mos flisni më, ndaloni  
8 së foluri dhe në qoftë se më shikoni që do të ngre dorën, po  
9 ashtu ndaloni së foluri, kjo do të thotë që më duhet t'ju jap  
10 disa udhëzime pasuese.

11 Nëse keni të nevojshme të bëni pushime, na e thoni këtë  
12 gjë dhe ne do të bëjmë organizimet e nevojshme për pushim.

13 Do fillojmë me pyetjet nga Prokuroria.

14 Z. Quick, mund të filloni me pyetjet.

15 Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

16 Pyetje nga z. Quick:

17 Z. QUICK: [Përkthim]

18 PY. Përshëndetje z. Kabashi. A më dëgjoni mirë?

19 PË. Po.

20 PY. Jemi takuar më përpara, megjithatë do prezantohem dhe  
21 njëherë për procesverbal. Unë quhem Nate Quick dhe punoj për  
22 Prokurorinë. Do t'ju bëj pyetje për rreth një orë e gjysëm  
23 sot.

24 Sikurse e kam shpjeguar dhe gjatë seancës përgatitore me  
25 Prokurorinë disa javë më përpara, në vend që t'ju bëj pyetje

1 lidhur me çdo çështje për të cilat ju mund të keni  
2 informacion, mund të jetë e mundur që të pranohen disa prej  
3 deklaratave të më hershme, të cilat përmbajnë informacionin e  
4 dhënë dhe ato të pranohen si prova në këtë proces gjyqësor.  
5 Për ta bërë këtë gjë do të duhet që të respektojmë disa hapa  
6 proceduralë të cilët do t'i kalojmë bashkërisht pasi të na  
7 thoni gjeneralitetet tuaj.

8 Dëshmitar, si quheni?

9 PË. Shefqet Kabashi

10 PY. Kur keni lindur?

11 PË. 1 korrik 1976.

12 PY. Shtetësia, z. Dëshmitar?

13 PË. Shqiptar.

14 PY. A flisni shqip, Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Keni zgjedhur që dëshminë ta jepni në anglisht sot. për  
17 çfarë arsye e keni bërë këtë gjë?

18 PË. Sepse nga deklaratat e mëhershme që kam dhënë, mendoj që  
19 shumë prej tyre kanë qenë të keqkuptuara për shkak të  
20 dialektit dhe gjërave të tjera të ngjashme, kështu që kam  
21 zgjedhur që të flas në shqip [sipas përkthimit]. Kështu që në  
22 qoftë se ka gjëra që nuk i kuptoj do të kem mundësinë që të  
23 pyes në mënyrë të drejtpërdrejtë.

24 PY. E kuptoj. Faleminderit, Dëshmitar. Për shkak se po flasim  
25 të dy në anglisht edhe pyetjet edhe përgjigjet do të jenë në

1 anglisht, siç kuptohet, kështu që është e rëndësishme për të  
2 dyja palët që të bëjmë një pauzë pasi të bëhet pyetja dhe të  
3 pritët përgjigja në mënyrë të tillë që t'i japim kohë të  
4 mjaftueshme përkthyesve për të kapur çdo gjë. A e kuptoni  
5 këtë, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Dëshmitar, a e mbani mend që  
8 keni dhënë dëshmi në TPNJN në çështjen gjyqësore kundër Limajt  
9 dhe të tjerëve më datë 11 dhe 14 mars 2005?

10 PË. Po.

11 Z. QUICK: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, do kërkoja  
12 që të paraqisni në ekran dokument IT-04-84bis P00119.

13 PY. Z. Kabashi, a shikoni një dokument në ekran?

14 PË. Po.

15 PY. Në faqen e parë në fillim fare, a shikoni datën që është  
16 11 mars 2005?

17 PË. Po.

18 PY. A e shikoni emrin tuaj në rreshtin 15?

19 PË. Po.

20 Z. QUICK: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, dëshiroj  
21 të paraqisni faqen 66 të këtij dokumenti. Ndërkohë faqja e  
22 transkriptit është 4240.

23 PY. Z. Kabashi, a e shikoni datën në fillim të kësaj faqeje  
24 që është 14 mars 2005?

25 PË. Po.

1 PY. A e shikoni emrin tuaj në rreshtin 17?

2 PË. Po.

3 PY. Z. Kabashi, a ju kujtohet që ju është dhënë mundësia që  
4 ta rishikoni këtë dëshmi kur jemi takuar bashkë në tetor?

5 PË. Po, besoj se po. Po.

6 PY. A ju është dhënë mundësia që të bëni sqarime dhe  
7 korrigjime lidhur me këtë dëshmi?

8 PË. Po.

9 PY. A ju kujtohen këto sqarime dhe këto korrigjime që të jenë  
10 përfshirë në një shënim që më pas ju lexua juve i plotë?

11 PË. Po.

12 PY. Z. Kabashi, a kujtoni që ju kërkua që të thoni që bashkë  
13 me korrigjimet dhe me saktësimet e bëra, dëshmitë tuaja  
14 pasqyronin dëshminë që do të jepni përpara Trupit Gjykses?

15 PË. Ma përsërisni edhe një herë?

16 PË. A ju kujtohet që ju është thënë që bashkë me korrigjimet  
17 edhe me saktësimet, dëshmitë e dhëna janë të plota dhe të  
18 sakta dhe pasqyrojnë dëshminë e dhënë prej jush saktësisht?

19 PË. Po.

20 PY. Z. Kabashi, duke marrë parasysh edhe korrigjimet në  
21 shënim, dëshmia në çështjen Limaj, a pasqyron qartë dhe me  
22 saktësi dëshminë tuaj dhe a do thoni të njëjtat gjëra që keni  
23 thënë në qoftë se do ju bëheshin këto pyetje përpara Trupit  
24 Gjykses.

25 PË. Ju lutem përmendeni, thojeni dhe njëherë?

1 PY. Po. Duke marrë parasysh korrigjimet që pasqyrohen në  
2 shënim, dëshmia që keni dhënë në çështjen Limaj, a pasqyrojnë  
3 me saktësi atë çfarë keni thënë përpara Trupit Gjykues më  
4 herët dhe atë çfarë do të thoni sot përpara Trupit Gjykues në  
5 qoftë se do t'ju bëheshin të njëjtat pyetje?

6 PË. Unë do përgjigjem sa më shumë të mundem.

7 PY. Do e përsëris edhe një herë pyetjen. Duke marrë parasysh  
8 edhe korrigjimet që janë pasqyruar në shënimin që ju lexua pas  
9 juve në seancën përgatitore, dëshmia e dhënë në çështjen Limaj  
10 a pasqyron me saktësi dëshminë tuaj?

11 PË. Cilën dëshmi?

12 PY. A është pasqyrim i saktë i dëshmisë që keni dhënë në  
13 çështjen Limaj?

14 PË. Dëshminë përpara Gjykatës në çështjen Limaj, përpara  
15 hetuesve në vitin 2004, unë kam thënë të vërtetën. Nuk kam  
16 thënë asgjë tjetër, kam thënë vetëm të vërtetën.

17 PY. Në qoftë se mund t'ju ndërpres, Dëshmitar. A më dëgjoni  
18 mirë se duket sikur ka pak shkëputje, ka pak ndërhyrje?

19 PË. Ju dëgjoj mirë.

20 PY. Kur keni dëshmuar në çështjen Limaj, a keni treguar të  
21 vërtetën, Dëshmitar?

22 PË. Po.

23 PY. Në qoftë se do ju bëj të njëjtat pyetje sot, pra, të  
24 njëjtat pyetje siç ju janë bërë në çështjen Limaj, a do jepnit  
25 të njëjtat përgjigje dhe sot?



1 PË. Në qoftë se është me dëshirën time jo, por pa dëshirën  
2 time atëherë, ju mund të bëni çfarë doni.

3 PY. Nuk jam i sigurt në qoftë se e kuptova përgjigjen tuaj.

4 Por keni konfirmuar se ajo çfarë keni dhënë dëshmi në çështjen

5 Limaj ka qenë e vërtetë. Pyetja që po të bëj tani është kjo,

6 nëse do t'ju bëja të njëjtat pyetje siç ju janë bërë në

7 çështjen Limaj në TPNJ, a do jepnit të njëjtat përgjigje dhe

8 sot në qoftë se do ju bëja të njëjtat pyetje?

9 PË. Po, më kërkoni që të konfirmoj, por unë kam konfirmuar

10 dhe ju kam treguar gjithçka dhe çfarë bëtë ju me atë

11 informacion. Nga gjyqi i parë, nga çështja Limaj, Haradinaj

12 dhe pastaj çfarë ndodhi, më pas çfarë ndodhi? Pas gjithë kësaj

13 kohe, tani që të jem këtu përpara jush sot nuk ka kuptim.

14 PY. Dua ta sqaroj edhe një herë tjetër në qoftë se më lejoni,

15 z. Kabashi.

16 Dua t'ju ndërpres.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Dëshmitari po flet dhe nuk dëgjojmë

18 dot nga mikrofoni, nuk kapet nga mikrofoni. Ju kërkohet ndjesë

19 po nuk po e dëgjojmë dot çfarë po thotë dëshmitari.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

21 Z. QUICK: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, ju konfirmuat që dëshmia që keni dhënë në

23 çështjen Limaj ka qenë e vërtetë, a është e saktë kjo?

24 PË. Deklarata që kam dhënë përpara gjykimit të Limajt,

25 mendohej që të ishte konfidente sepse besoj se çfarë mendoj,

1 çfarë shoh, çfarë dëgjoj --

2 PY. Ju kërkoj ndjesë që po ju ndërpres z. Kabashi, se nuk  
3 ishte kjo pyetja ime.

4 PËRKTHYESJA: Dëshmitari nuk dëgjohet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju  
6 lutem prisni derisa të përfundojë pyetjet z. Quick.

7 Z. QUICK: [Përkthim]

8 PY. Z. Kabashi, ju sapo konfirmuat që dëshmia e dhënë në  
9 çështjen Limaj ishte e saktë. Pyetja ime ishte vetëm kjo, a ka  
10 qenë e saktë dëshmia që keni dhënë në atë çështje?

11 PË. E kuptoj. E dëgjova pyetjen dhe i dhashë përgjigjen. Po  
12 dëshiroj t'ju them Gjykatësve ku po më çon mua kjo gjë?

13 Gjykatësit e dinë se çfarë kam hequr, çfarë kam kaluar gjithë  
14 këtyre viteve pas dëshmisë së parë që kam dhënë. Dhe Gjykatësi  
15 e di dhe ju i keni thënë emigracionit këtu që kam bashkëpunuar  
16 me terrorizmin dhe kanë revokuar dokumentet e mia.

17 PY. Do vazhdojmë me tema të tjera dhe sigurisht që do të jap  
18 mundësinë që të jepni shpjegime lidhur me proceset e mëparshme  
19 gjyqësore. Por, për momentin, tani për tani, thjesht po ju bëj  
20 pyetje lidhur me çështjen Limaj. Dhe po ju pyes, në qoftë se  
21 do ju bëja të njëjtat pyetje, siç kanë bërë pyetje në çështjen  
22 Limaj, do jepnit të njëjtat përgjigje, a kanë qenë të vërteta  
23 ato përgjigje?

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam përshtypjen që kemi një problem  
25 se duhet të lëmë dëshmitarin që të përfundojë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po dëgjon  
2 dëshmitari e përfundoi dhe tani po bëjmë pyetje Prokurori,  
3 kështu që do vazhdojmë më tej.

4 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Megjithatë  
5 për ju është e thjeshtë që të thoni që duhet të vazhdojmë  
6 andej, për mua nuk është kaq e thjeshtë.

7 Z. QUICK: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, kjo pjesë e pyetjeve të mia kanë të bëjnë  
9 vetëm thjesht me disa çështje procedurale.

10 PË. Çdo pjesë, çdo pyetje ka të bëjë me 20 vite të jetës time  
11 dhe ju nuk keni bërë asgjë lidhur me të. Dhe për këtë dua që  
12 të flas. Në qoftë se më lejoni, Gjykatësit, dua të flas me  
13 Gjykatësin. Unë kam qenë i sjellshëm me ju sepse ju më keni,  
14 pra, e dini që unë vetë nuk kam vendosur, nuk ka qenë  
15 gatishmëria, vendimi im për të ardhur. Megjithatë jeni  
16 përpjekur që të gjeni të gjithë mënyrat e mundshme në mënyrë  
17 që të më sillni këtu. Edhe për këtë arsye nuk mund të  
18 bashkëpunoj me ju, sinqerisht, me Prokurorët, sepse ju dëmtoni  
19 kaq shumë njerëz, keni dëmtuar kaq shumë njerëz, përfshirë  
20 këtu edhe dëshmitarët edhe gjithë vendin tim.

21 PY. Dëshmitar, do e vlerësoja shumë në qoftë se do të jepnit  
22 përgjigje pyetjeve që po ju bëj. Do t'ju jap mundësinë që të  
23 shpjegoni se çfarë ka ndodhur në proceset e mëparshme  
24 gjyqësore kur të vijë momenti i përshtatshëm.

25 Dëshmitar, në tetor kur jemi takuar për seancën

1 përgatitore me dëshmitarin, pra, me ju, juve më keni thënë që  
2 e kujtoni që ju është dhënë mundësia që të rishikoni dëshminë  
3 në çështjen Limaj. Po ashtu e konfirmuat sot që ju është dhënë  
4 mundësia për të bërë sqarime dhe korrigjime për dëshminë e  
5 dhënë në çështjen Limaj në TPNJ dhe kjo është përfshirë në një  
6 shënim të Prokurorisë që është lexuar më pas juve.

7 Z. QUICK: [Përkthim] Znj. Sekretare, nëse është e mundur,  
8 do të doja që të kërkoja që të transmetohet në ekran dokumenti  
9 i Prokurorisë që është Shënimi Përgatitor 116141. Të kalojmë  
10 tek faqja e dytë, paragrafi 10. Ndjesë faqja e tretë, jo e  
11 dyta.

12 PY. Dëshmitar, në këtë shënim shkruhet që ju e keni  
13 konfirmuar këtë që shkruhet këtu, shkruhet:

14 "Kur pyet Dëshmitari 04448" që është kodi juaj tha se  
15 "synonte që të konfirmonte që dëshmia e tij në çështjen Limaj  
16 më 11 dhe 14 mars së bashku me sqarimet dhe korrigjimet e  
17 sipërpërmendura ishte e vërteta".

18 A e konfirmoni të njëjtën gjë sot, Dëshmitar?

19 PË. Po më pyesni mua?

20 PY. Po.

21 PË. Po. E thashë në fillim fare. E thashë që çdo gjë që kam  
22 thënë dhe dëshmitë e mia, sepse ndonjëherë gjërat që kam thënë  
23 janë transmetuar gabimisht. Dhe unë kam thënë atë çfarë kam  
24 thënë dhe çfarë kam thënë ka qenë e vërteta. Nuk kam thënë  
25 asgjë tjetër ndryshe. E vërtetë është.

1 PY. Faleminderit. Faleminderit, Z. Kabashi.

2 Z. QUICK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është e qartë  
3 që Dëshmitari konfirmon vërtetësinë dhe saktësinë e dëshmisë  
4 në çështjen Limaj. ZPS-ja kërkon që të pranohet si provë  
5 materiale dëshmia në çështjen Limaj sipas rregullës 154.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po shënimi?

7 Z. QUICK: [Përkthim] Po së bashku me shënimin përgatitor  
8 dhe provat materiale shoqëruese.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtim?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Për procesverbal, a tha dëshmitari  
11 që pajtohet me shënimin përgatitor?

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk e kapa atë pjesën. Nuk kam  
14 kundërshtim.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Pozicioni im është neutral.

16 Qëndrimi im është neutral lidhur me këtë. Është një çështje që  
17 për të cilën duhet të mbaj qëndrim prej jush, të nderuar  
18 Gjykatës.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] E njëjta gjë vlen dhe për mua, të  
20 nderuar Gjykatës.

21 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Deklarata IT-04-84bis P00119 së bashku me Shënimin Përgatitor  
24 numër 1, që është dokumenti 116141 dhe dokumentet shoqëruese  
25 pranohen si prova materiale.

1           Z. QUICK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të  
2 sqaroj ERN-të që duhet të pranohen si prova materiale. Po  
3 ashtu, për të qenë i plotë, kërkoj pranimin si provë materiale  
4 të versionit konfidencial të deklaratës së dëshmitarit të  
5 datës 14 mars 2005 që është IT-03-66-AT E Paredaktuar dhe  
6 gjithashtu kërkojmë pranimin si provë materiale të  
7 regjistrimit audioviziv, përfshirë këtu edhe dëshminë në shqip  
8 të dëshmitarit në çështjen Limaj. Është dokumenti identifikuar  
9 si IT-03-66 11 mars 2005, Shefqet Kabashi që mund të  
10 klasifikohet si publike, si dhe dokumenti IT-03-66 që është  
11 version konfidencial.

12           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përderisa nuk  
13 u përmendën më përpara, duhet t'ju kërkoj palëve në qoftë se  
14 kanë kundërshtim për dokumentet e shtuara së fundi.

15           Z. Emmerson, mendoj që keni të njëjtën përgjigje apo jo?

16           Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

17           KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull  
18 atëherë. Edhe këto dokumente pranohen si prova materiale dhe  
19 do ju caktohen numrat përkatës të provave materiale.

20           SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në  
21 qoftë se më lejoni. Transkripti i parë në çështjen Limaj që ka  
22 numër identifikimi IT-04-84bis P001119 do të marrë numrin e  
23 provës material P730.

24           Shënimi Përgatitor i identifikuar paraprakisht si 1166141  
25 deri në 115143, do të marrë numrin e provës materiale P731.

1 Transkripti i paredaktuar me numrin IT-03-66 T4240 deri  
2 në T4246 i paredaktuar do të marrë numrin e provës materiale  
3 P732.

4 Dhe të dy videot, sikurse u përmendën, përkatësisht IT-  
5 03-66 11 mars, Pjesa 1 dhe 2 dhe prova materiale është 733.1  
6 për Pjesën 2 dhe prova materiale 732.2 për Pjesën 2. Ndërkohë  
7 sa i takon ERN për videon tjetër, në qoftë se mund ta  
8 përsërisësh edhe njëherë Prokuror?

9 Z. QUICK: [Përkthim] Video tjetër identifikohet si IT-03-  
10 66 2005-03-14 e paredaktuar, Pjesa 1 deri në Pjesën 2.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Këto do të marrin  
12 numrin e provës materiale P734.1 dhe 734.2. Faleminderit.

13 E di që këto janë të klasifikuara të gjitha  
14 konfidenciale, po thjesht për sqarim. A është e vërtetë që të  
15 gjitha do të klasifikohen si konfidenciale?

16 Z. QUICK: [Përkthim] Dokument IT-04-84bis P00119 mund të  
17 jetë publik.

18 IT-03-66, dhe të gjitha ato të cilat janë "të  
19 paredaktuara" në ERN duhet që të jenë konfidenciale.

20 Ndërkohë që dokumenti IT-03-66 i datës 11 mars 2005,  
21 Shefqet Kabashi, Pjesët 1 deri në 2 mund të jenë publike.

22 Ndërkohë shënimi përgatitor numër 1 që është 1166141  
23 duhet që të klasifikohet si publik.

24 Dhe provat materiale shoqëruese duhet që të klasifikohen  
25 si publike.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se  
2 nuk ka kundërshtime, këto klasifikime do ndryshohen në publike  
3 sikurse u përmendën nga Prokurori.

4 Mund të vazhdoni, z. Quick.

5 Z. QUICK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.  
6 PY. Z. Kabashi, ju ndërpreva pak më herët kur po përpiqeshit  
7 që të jepnit një shpjegim. Ndërkohë tani dëshiroj që të  
8 diskutojmë pak së bashku atë çfarë ka ndodhur në proceset  
9 gjyqësore të mëparshme duke filluar me Limajn dhe duke  
10 vazhduar më tej deri në çështjen për të cilën jemi këtu.

11 Është shumë e rëndësishme që të mos flasim mbi njeri-  
12 tjetrin. Kur t'ju bëj një pyetje ose kur të përpiqem që t'ju  
13 ndërpres është e rëndësishme që juve t'i përgjigjeni menjëherë  
14 pyetjes time. Sepse në të kundërtën procesverbali nuk do jetë  
15 i qartë, askush nuk do ju dëgjojë çka do thoni juve, unë nuk do  
16 ju dëgjojë çka do të thoni. Kështu që dua t'ju pyes, a e  
17 kuptuat këtë Dëshmitar?

18 PË. Po.

19 PY. Z. Kabashi, ju keni dhënë dëshmi me masa mbrojtëse,  
20 identiteti juaj nuk është bërë i ditur për publikun. Keni  
21 shpjeguar për gjykatësit në atë që ishte shumë e vështirë për  
22 juve për të dhënë dëshmi dhe se ju ishit thirrur tradhtar.  
23 Keni shpjeguar gjithashtu që kur keni shkuar për të dhënë  
24 dëshmi, familja juaj është kërcënuar.

25 Dëshmitar, pavarësisht vështirësive që keni përshkruar,



1 pse keni dhënë dëshmi në çështjen Limaj, cila ka qenë arsyeja  
2 e dhënies së dëshmisë tuaj?

3 PË. Ju lutem, a e thoni dhe një herë pyetjen? Cila ishte  
4 pyetja?

5 PË. Në çështjen Limaj keni dhënë dëshmi, ka qenë e vështirë  
6 për juve për të dhënë dëshmi sepse jeni thirrur tradhtar dhe  
7 ju kanë kërcënuar familjen. Pse vendose që pavarësisht këtyre  
8 kërcënimeve dhe akuzave të bëra ndaj jush edhe faktit që ju  
9 kanë quajtur tradhtar, pse vendosët gjithsesi që të jepnit  
10 dëshmi?

11 PË. Mund të filloj nga fillimi i UÇK-së kur filluan që të  
12 marrin masa dhe policia, pra, e forcat e policisë serbe --

13 PY. Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres, Dëshmitar. Pyetja ime  
14 është kjo, pse vendosët të jepnit dëshmi në çështjen Limaj?

15 PË. Këtu do dilja dhe unë, këtë doja të shpjegoja dhe unë.

16 PY. Mirë. Në rregull. Të lutem përgjigju pyetjes.

17 PË. Sepse nga viti 1998, që kam marrë urdhra nga komandanti i  
18 mëparshëm për të vrarë njerëz dhe nuk i kam vrarë këto njerëz.  
19 Dhe ato nuk ndaluan asnjëherë edhe pse unë isha në burg. E kam  
20 ditur që jeta ime ka qenë në rrezik, po për mua ka qenë më e  
21 rëndësishme që të ndaloja, por unë u dorëzova asnjëherë. Nuk  
22 doja që të dorëzohesha, sepse nuk ishte e nevojshme t'i bënim  
23 ato gjëra, në kuptimin që të vrisnim njeri-tjetrin për besime  
24 të ndryshme ose për arsye të ndryshme politike. Ne jemi të  
25 gjithë shqiptarë dhe nuk i bëjmë gjëra të tilla çfarë kemi

1 bërë në luftë dhe çfarë kemi bërë në luftë dhe më pas luftës.

2 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Kur dole si dëshmitar në gjyqin

3 Haradinaj ju përgjigje pyetjeve të Prokurorisë?

4 PËRKTHYESJA: Nuk kuptohet përgjigja.

5 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Sa më

6 kujtohet u jam përgjigjur disa pyetjeve. Por nuk desha sepse

7 pas çështjes Limaj-Haradinaj të 2007, jo, sepse lashë dhe në

8 letër në hotel në dhomën e hotelit ku u përpoqa të shpjegoj

9 sepse me sa shihej askush nuk mund t'i ndalonte krimet që

10 vazhdonin të kryheshin.

11 PY. Faleminderit. Kur dëshmuat në gjyqin e Haradinajt, kishit

12 masa mbrojtëse?

13 PË. Jo.

14 PY. Pse jo?

15 PË. Sepse u përpoqa t'i shpjegojë gjykatës se masa mbrojtëset

16 nuk kishin asnjë kuptim. Nuk ishin të tilla. Sepse krimi i

17 organizuar vazhdonte, kur ata e dinë që dikush del si

18 dëshmitar, sidomos për jep dëshmi për disa persona të UÇK-së,

19 në qoftë se ai e di dhe fletë për atë që di, masa mbrojtëse

20 s'kanë vlerë.

21 PY. Pra, masat mbrojtëset në çështjen Limaj i keni menduar si

22 efikase?

23 PËRKTHYESJA: Nuk dëgjohet mirë. S'kuptohet mirë.

24 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Të

25 padobishme.

Dëshmitari: W04448 (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Quick

Faqe 19

1 Z. QUICK: [Përkthim]

2 PY. Pse të janë dukur të padobishme?

3 PË. Sikurse dhe më parë --

4 PËRKTHYESJA: Nuk dëgjohet.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,

6 nuk dua t'ju ndërpres, po kemi vështirë t'ju dëgjojmë.

7 Punonjëse e Gjykatës, a mund t'i rregulloni disi

8 mikrofonat që t'i ketë më afër dëshmitari?

9 Dëshmitar, nuk duam që të na shpëtojë asgjë nga ato që

10 thua, por herë pas here ndërpritet. Prandaj përpiqu të flasësh

11 me një ritëm konstant. Jam i sigurt për këtë është çuar dhe z.

12 Kehoe në këmbë.

13 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Këtë po bëj.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Po nuk kuptohet çfarë tha

15 dëshmitari.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdo. Ju

17 kërkoj ndjesë që ju ndërpremë, por duhet të dëgjojmë ato që

18 thoni.

19 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] I thashë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëhere po ju

21 bëjmë një pyetje tjetër.

22 Z. QUICK: [Përkthim]

23 PY. Faleminderit, z. Kabashi. Kur u paraqitët në gjykimin

24 tjetër të Haradinajt në 2007, a ju përgjigjët pyetjeve të

25 Prokurorisë, në 2011?

1 PË. Në fakt nuk desha të përgjigjem. E keni informacionin për  
2 këtë. Ju e dini u përgjigja apo jo e përse nuk u përgjigja.

3 PY. Përse nuk u përgjigjët apo përse dhatë përgjigjet që  
4 dhatë?

5 PË. Sepse që nga lufta krimet nuk kanë reshtur. Dhe ju si  
6 Prokurori nuk bëtë asgjë për t'i ndaluar. As EULEX-i, as  
7 shërbimi policor dhe të gjithë nuk bënë asgjë për t'i ndaluar.  
8 Dhe mendoj që këto janë -- ky është institucioni më i  
9 korruptuar që ka qenë ndonjëherë, që kam parë unë, nëse mund  
10 ta them këtë gjë. Pra, nëse unë besoj se mund t'i them ato që  
11 besoj.

12 PY. Kuptohet. Prej jush kjo pritet sot të thoni të vërtetën.  
13 Vazhdoni, z. Kabashi.

14 PË. Ata u përpoqën gjithashtu sepse nuk bashkëpunova me ta  
15 atëherë në mënyrën që ata donin. U përpoqën të më bënë dëm  
16 duke dërguar në letër në emigracion, ku thonin që ai  
17 bashkëpunon me terrorizmin, përpiqet të bombardojë zyrat në  
18 Bruksel, zyrat e tribunalit. Nga 2007 deri në 2009, kam shkuar  
19 prapë për intervista. Dokumentet e mia u bllokuan, m'u hoqën  
20 atëherë. Tani do të shkoj prapë në gjykatë. Dhe të gjitha këto  
21 dhe për të gjitha këto jeni ju fajtorë.

22 PY. Kur ju pyeta më parë për arsye pse dëshmuat në Limaj, ju  
23 përmendët një urdhër, urdhrat që keni marrë si anëtar i UÇK-  
24 së.

25 Dhe dua t'ju pyes për këto urdhra. E kuptoj që ka kaluar

1 shumë kohë që nga ajo kohë. Prej jush pritet vetëm të thoni të  
2 vërtetën dhe të jepni informacionin që u kujtohet tani.

3 Dakord?

4 Z. QUICK: [Përkthim] Dhe të nderuar Gjykatës, unë e  
5 kalova përmbledhjen e rregullës 154. Propozoj ta lexoj më pas,  
6 nëse jeni dakord.

7 PY. Dëshmitar, në dëshminë tuaj në çështjen Limaj, që është  
8 pranuar si provë materiale, ju thatë se keni marrë urdhra të  
9 vrisni një person të quajtur Rrok Berisha në fund të shtatorit  
10 apo në fillim të tetorit 1998. Ju thatë që pasi e morët  
11 urdhrin shkuat për të folur me Rrok Berishën dhe i treguat për  
12 këtë urdhër. Dëshmuat se pasi folët me Rrok Berishën nuk e  
13 vratë, por përkundrazi shkuat, u kthyet në shtëpi. Pasi u  
14 kthyet në shtëpi, keni folur më ndonjëherë me Rrok Berishën  
15 për këtë urdhër?

16 PË. Vetëm pas lufte. Në 2003 apo 2004.

17 PY. Sa herë keni folur me të pas lufte?

18 PË. Nuk më kujtohet. Disa herë.

19 PY. Disa herë? Shumë herë folët me të, z. Kabashi?

20 PË. Po.

21 PY. Pse folët me të?

22 PË. Një nga arsyet që fola me të ishte se pas lufte emri im  
23 doli në një artikull gazete, nuk më kujtohet tamam si quhej.

24 PËRKTHYESJA: Mezi dëgjohet.

25 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Koha e Re më

1 duket në shqip quhej gazeta dhe Faton Mehmetaj ishte personi  
2 që shkruante kundër Rrok Berishës.

3 PËRKTHYESJA: Nuk kuptohet.

4 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] E përdorën  
5 emrin tim për këtë qëllim. Dhe nuk duroja dot më. Mbas lufte  
6 vendosa të mos -- të filloj të punoj. Bëra kërkesë të punoja  
7 si oficer policie, por kur vajta të merrja vërtetimin që kam  
8 qenë anëtar i UÇK-së refuzuan të ma jepnin.

9 Kur e përdorën emrin tim duke thënë që unë isha në anën  
10 tjetër të luftës, pra, në fakt, i binte të isha njeri i keq.  
11 Vendosa që të shkruaj në Bota Sot për një javë apo për më  
12 shumë se një javë, duke rrëfyer gjithçka për familjen time dhe  
13 për veten, për kohën e luftës, por edhe në burg për burgun,  
14 kohën që kam kaluar në burg.

15 Z. QUICK: [Përkthim]

16 PY. Faleminderit, z. Kabashi.

17 PË. Prandaj jam takuar me Rrok Berishën. Kjo ishte arsyeja.  
18 Po kishte gazetarë të tjerë që nuk donin ta merrnin përsipër  
19 këtë çështje sepse kishin frikë përpara rrjetën e tyre.

20 PY. Kur e takuat Rrok Berishën pas lufte, çfarë diskutuat z.  
21 Kabashi?

22 PË. Diskutuam shumë gjëra. Nuk e di çfarë doni të dini ju  
23 konkretisht?

24 PY. Ju thatë që kishit shkruar letra Bota Sot. Po Rrok  
25 Berisha bëri ndonjë deklaratë publike apo shkroi ndonjë

1 artikull lidhur me ju dhe përvojën tuaj në luftë?

2 PË. Çfarë doni të thoni?

3 PËRKTHYESJA: Nuk kuptohet.

4 Z. QUICK: [Përkthim]

5 PY. Ju dëshmuat se kishit marrë urdhër për të vrarë Rrok

6 Berishën. Po Rrok Berisha bëri ndonjë deklaratë publike apo

7 shkroi ndonjë artikull pas lufte për këtë gjë?

8 PË. Po, disa herë. Po herën e fundit që e bëri këtë gjë,

9 ishte përpara se të vdiste në llogarinë e tij në Facebook. Aty

10 tregoi se nuk isha vetëm unë. Edhe pas meje u përpoqën përsëri

11 ta vrisnin. Këto mund t'i gjeni.

12 PY. A ju kujtohet ndonjë gjë tjetër që të ketë thënë në këtë

13 postim në Facebook?

14 PË. Ç'doni të thoni? Çarë keni parasysh?

15 PY. A ju kujtohet çfarë tha ai në këtë postimin në Facebook

16 përveç këtyre që thamë?

17 PË. Tha që është e vërtetë ato që thotë Kabashi në intervistën

18 që kisha, që dhashë.

19 PY. Çfarë tha se ishte e vërtetë? Përpara çfarë e kishe

20 fjalën?

21 PË. Për rastin e 1998 kur shkova në shtëpinë e tij. Unë e

22 njihja Rrok Berishën, njihja dhe familjen e tij, ishte një

23 familje e mirë shqiptare. E di që kishte një farë keqkuptimi.

24 Probleme lidhjeje?

25 PY. Më dëgjoni mirë, z. Kabashi?

1 PË. Po, ju dëgjoj.

2 PY. Pra, ju thatë që Rrok Berisha shkroi artikuj. Thatë që e  
3 shkroi në Bota Sot.

4 Z. QUICK: [Përkthim] I lutem, Sekretares, të paraqesë në  
5 ekran dokumentin me numër ERN 0093209 dhe të tregojnë faqen me  
6 numrin ERN U0009-3224. Dua që të tregoni në ekran vetëm një  
7 faqe, atë konkrete që përmenda. Mund të jetë publike.

8 Gjithashtu mund të transmetohet dhe përkthimi anglisht i  
9 pjesës përkatëse me numër U009-3225 deri në 00093226.

10 PY. Z. Kabashi, e shikoni në ekran këtë dokumentin?

11 PË. Po. Nuk është i lexueshëm, nuk lexohet dot por e shoh.

12 Z. QUICK: [Përkthim] Mund ta zmadhojmë ju lutem këtë  
13 dokument.

14 PY. Dëshmitar, në anën, në qoshen e djathtë lart, e shikoni  
15 datën 12 dhjetor 2005?

16 PË. Po.

17 PY. Pastaj poshtë Bota Sot?

18 PË. Po.

19 PY. Çfarë ishte Bota Sot?

20 PË. Ishte një gazetë.

21 PY. E shikoni artikullin në krahun e djathtë të faqes? Fillon  
22 me fjalët "Ish-komandantët kanë rifilluar kërcënimet".

23 PË. Po.

24 PY. E keni parë më parë këtë artikull?

25 PË. Mund ta kem parë, po s'më kujtohet.



1 PY. Shikoni tek kolona e dytë, në fillim të kolonës së dytë.

2 Përmendet një person me emrin Pipi.

3 PË. Po.

4 PY. E shikoni?

5 PË. Po, e shoh.

6 PY. Kush është Pipi? Nëse e dini.

7 PË. Po. Pipi është Alush Agushi i quajtur edhe Mula. Ishte

8 gjithashtu dhe ai anëtar i UÇK-së. Nuk e di kur është futur në

9 UÇK. Unë isha në njësinë e tij për një farë kohe.

10 PY. Faleminderit. Për këtë keni dhënë prova në dëshminë që

11 keni dhënë në çështjen Limaj, kështu që s'po flasim për këtë

12 tani. Por shikoheni përsëri artikullin dhe shikoni në fund të

13 paragrafit të parë në atë kolonë. Dhe shikoni të gjeni fjalën

14 "Shulci".

15 PË. Po aty në fund gati. Në fund të paragrafit në kolonën e

16 dytë.

17 PY. Lexojeni atë fjali dhe fjalinë tjetër dhe ndërkohë që ju

18 e lexoni, unë do të lexoj përkthimin në anglisht të të njëjtës

19 pjesë. E di që e keni vështirë ta lexoni në ekran këtë në

20 shqip.

21 Z. QUICK: [Përkthim] Përkthimi është në faqen U009-3226.

22 Katër rreshta më poshtë.

23 PY. Dhe e ka fjalën për këtë Pipin për të cilin sapo

24 diskutuam:

25 "Urrejtjen e tij dhe mendja tij e ligë është treguar edhe

1 në 26 tetor 1998, kur urdhëroi ushtarin e UÇK-së, ndryshe  
2 'Shulc' të vriste një deputet në luginën e vogël të Baranit.  
3 Dhe po 'Shulci' nuk e pranoi urdhrin".

4 Kush është personi i quajtur Shulc në këtë artikull, z.  
5 Kabashi?

6 PË. Isha unë.

7 PY. Kjo është një nofkë?

8 PË. Po.

9 PY. Kush ia dha Shulcit apo juve urdhrin për të cilin flitet  
10 këtu?

11 PË. Mund ta përsërisni edhe një herë?

12 PË. Kush jua dha këtë urdhër për të cilin po flasim për të  
13 vrarë këtë deputetin në luginën e Baranit?

14 PË. I njëjti person që ishte më parë.

15 PY. Kush është ky?

16 PË. Alush Agushi.

17 PY. E dini ju kush është personi që përmendet këtu si deputet  
18 i luginës së Baranit dhe shefi i informacionit të Brigadës  
19 131? Kush ka qenë ky?

20 PË. Është Isa Berisha.

21 PËRKTHYESJA: Nuk është e qartë.

22 Z. QUICK: [Përkthim]

23 PY. Më falni edhe një herë, kush është ky personi që  
24 përshkruhet si deputet i luginës së Baranit?

25 PË. Rrok Berisha. Ai përgjigjej dhe për informim, për t'i

1 dhënë informacioni Presidentit Rugova, që në fakti ishte në  
2 mërgim në atë kohë. Rrok Berisha ishte përgjegjës edhe për të  
3 ndihmuar popullsinë --

4 PËRKTHYESJA: Nuk kuptohet mirë. Nuk kuptohet.

5 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] -- për t'i  
6 furnizuar me ushqim e tjera.

7 Z. QUICK: [Përkthim]

8 PY. Kjo pjesa e artikullit që sapo ju lexove a është në  
9 përputhej me ato që ju kujtoni nga ngjarjet e asaj kohe?  
10 PË. Çfarë doni të thoni?

11 PË. Është e saktë që keni marrë urdhër nga Pipi për të vrarë  
12 deputetin e luginës së Baranit që tani e identifikuat si Rrok  
13 Berisha?

14 PË. Po.

15 Z. QUICK: [Përkthim] Kërkoj të nderuar Gjykatës, që ky  
16 artikull bashkë me përkthimin në anglisht të pranohet si provë  
17 materiale me numër U009-3224 deri në 3226.

18 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ne kemi kundërshtim për pranimin  
19 e gjithë dokumentit. Kështu që mbase më mirë është ta shënoni  
20 për identifikim. Në qoftë se më lejoni dua ta shpreh pse.

21 Për sa thuhet këtu, si paraqitje të këtij materiali si  
22 provë provuese, dëshmi provuese --

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,  
24 duhet t'i hiqni kufjet sepse do të diskutojmë diçka jashtë  
25 pranisë tuaj. Më dëgjoni?

1           Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk është shumë e ndjeshme. Po  
2 kjo që ju tha dëshmitari për të cilin u pyet është një pjesë e  
3 një artikulli të Rrok Berishës që i referohet këtij dëshmitari  
4 se i ka thënë atë që ky i ka thënë. Nuk provon akuzën. Por  
5 provon se i njëjti burim i tha të njëjtën gjë këtij. Dhe nuk  
6 ka material të pavarur që të provojë këtë që thotë dëshmitari  
7 në kuptimin teknik sepse është nga i njëjti burim. Është  
8 thjesht provë të një deklaratë të asaj kohe, po jo provuese.  
9 Dhe siç ndodh, siç është praktike e kësaj Gjykate, në raste të  
10 dokumenteve të tilla, dëshmitarit i lexohet dokumenti dhe  
11 pranohet në bazë të transkriptit. Dhe jo vetëm në bazë të  
12 kësaj një pyetje që i bëhet. Duhet që t'ju përmbahemi  
13 rregullave.

14           Z. KEHOE: [Përkthim] Edhe unë kam kundërshtim për bazën e  
15 pyetjeve. Ky dëshmitar s'e ka parë. Nuk e mban mend ta ketë  
16 parë këtë dokument. Prokurori ia tregon atij dhe ai nuk mund  
17 ta verifikojë atë që ka parë.

18           Këto janë komente që shkëmbehen, kështu që dhe unë do të  
19 kundërshtoja kryesisht për themelin e saj, po jam dakord edhe  
20 me ato që thotë z. Emmerson.

21           Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë nuk po bëjë një argument  
22 thjesht për ta ndjekur dhe z. Kehoe.

23           Shqetësimi im është që praktika e vendosur në Gjykatë në  
24 rastin e përdorimit të këtyre lloj materialeve është që  
25 fragmenti për të cilin pyetjet dëshmitari të pranohet vetëm

1 për bazë të faktit që ai pyetet.

2 Pra, është kjo është e pavarur. Përse në rastin e këtij  
3 dëshmitari të përdorim një metodë tjetër? Në këtë rast përsëri  
4 është një fragment nga një pjesë dëshmie që pastaj bëhet  
5 dëshmi. Pra, duket se po ndiqet një qasje tjetër, sepse  
6 Avokati tjetër ndoqi një qasje tjetër.

7 Z. QUICK: [Përkthim] Shumica e argumenteve lidhen me  
8 vlerën e përgjithshme provuese të nenit, data e të cilit është  
9 e qartë, jepet aty. Dëshmitari thotë atë që di. Përmbajtja  
10 është e qartë. E gjithë faqja mund të pranohet edhe pse ne do  
11 të përdorim vetëm një pjesë të saj.

12 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I gjithë  
14 artikulli me numër ERN U009-3224 deri në 226 pranohet.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të kërkoj sqarim për dy  
16 fjali përse në këtë rast ju po vendosni ndryshe nga ç'keni  
17 vendosur në rastet të tjera.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është një  
19 deklaratë e qartë. Ky zotëri e ka njohur këtë artikull. Ka  
20 datë. Është autentik. Vjen nga një burim i njohur. Ai e ka  
21 pranuar se i ka bërë këto deklaratë dhe është e pranueshme.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kemi një keqkuptim faktik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ia vlen  
24 të diskutojmë. Unë e dhashë vendimin për këtë tani.

25 Vazhdo, z. Quick.

1 Më falni, duhet t'i jepet një numër dokumentit.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Artikulli me numër ERN  
3 U009-3224 deri në 26 i jepet numri provë materiale P735.

4 Do të vazhdojë të jetë publik apo konfidencial?

5 Z. QUICK: [Përkthim] Mund të bëhet publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
7 riklasifikohet si publik në qoftë se nuk ka ndonjë  
8 kundërshtim.

9 Z. QUICK: [Përkthim] Një faqe, vetëm një faqe mund të  
10 jetë publike. Pjesa tjetër duhet të vazhdojë të jetë  
11 konfidenciale.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

13 Z. QUICK: [Përkthim] Besoj që dëshmitari duhet t'i  
14 vendosi përsëri dëgjueset.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
16 Dëshmitar. Do të vazhdojmë më tej.

17 Z. QUICK: [Përkthim

18 PY. Z. Kabashi, diskutuam atë urdhrin që morët nga Alush  
19 Agushi për të vrarë Rrok Berishën. Keni marrë edhe urdhra të  
20 tjerë të ngjashme nga Alush Agushi?

21 PË. Po. Kam marrë edhe një urdhër tjetër, nga z. Gashi.

22 PY. Kishte të bënte me njeri tjetër? Për Fadil Gashin vetëm  
23 ishte apo kishte?

24 PË. Fadil Gashi, Din Berisha.

25 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Këtë urdhër e keni marrë

1 përpara sesa urdhrit që morët për Rrok Berishën?

2 PË. Përpara.

3 PY. Ku e morët këtë urdhër?

4 PË. Ç'doni të thoni me "ku"?

5 PY. Urdhrin që thatë se e morët lidhur me Fadil Gashin dhe

6 Dine Berishën, ku ishit kur e morët këtë urdhër?

7 PË. Isha në rrugë duke shkuar nga Jabllanica me disa anëtarë

8 të UÇK-së dhe disa të afërm po shkonim drejt -- do të shkonim

9 në --

10 PËRKTHYESJA: Nuk u mor vesh se ç'tha.

11 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Kam disa të

12 afërt --

13 PËRKTHYESJA: Nuk kuptohet se ç'thotë.

14 Z. QUICK: [Përkthim]

15 PY. Z. Kabashi, më falni që po ju ndërpres, po zëri u ndërpre

16 nuk merret vesh. Nëse është e mundur, a mund ta filloni ta

17 thoni dhe njëherë përgjigjen mbase dëgjojmë më mirë?

18 PË. Po. Thashë që mora urdhër nga Alush Agushi. Atë ditë

19 shkoja nga Jabllanica në fshatin Volljakë, ku ka dhe një --

20 është dhe një lumë.

21 PY. Ju kërkoj ndjesë, z. Kabashi. Ju kërkoj ndjesë. Dua të

22 sigurohem që të jetë kapur kjo dëshmi që u tha, po u bë një

23 ndërprerje tjetër.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një minutë.

25 Dëshmitar, mos lëvizni shumë kur dëshmoni mos e lëvizni

1 kokën sepse mbase kjo ndikon në ndërprerjen e lidhjes. Mbase e  
2 keni të vështirë po përpiquni të shikoni drejtë, mos e lëvizni  
3 kokën kur jepni dëshmi.

4 Z. QUICK: [Përkthim]

5 PY. Pra, gjërat e fundit që keni thënë në procesverbal është  
6 që ju keni marrë urdhrin:

7 "Unë thashë që mora urdhrin nga Alush Agashi. Dhe atë  
8 ditë po shkoja nga Jabllanica në një fshat që quhej Bojakë  
9 [sipas përkthimit]", besoj që kjo ishte përgjigja e saktë.  
10 PË. Po.

11 PY. A mund të vijoni më pas?

12 PË. Po. Ai po vinte drejt Jabllanicës dhe u takuam atje. Dhe  
13 Alushi po përpiqej të afrohej tek uji, tek i njëjti vend. Po  
14 prisja. Ai më pa. E njoha. Edhe ai më pa mua. E pashë. Doli  
15 nga makina. Biseduam. Ai më tha që ata kanë disa probleme me  
16 Fadil Gashin dhe që ai është që ka dalë kundër UÇK-së dhe nuk  
17 po u bindet urdhrave. Këto lloj gjërash dhe që duhet  
18 eliminuar.

19 PY. Çfarë do të thotë kjo, si e kuptoni ju këtë fjalë?

20 PË. Që duhet të eliminohet me pak fjalë.

21 PY. Në rregull. Dhe ju thatë që e patë Alush Agushin në këtë  
22 kryqëzim afër lumit. Alush Agushi ishte me ndokënd? Kishte  
23 ndokënd tjetër me të?

24 PË. Po, ishin dy makina, ashtu siç e mbaj mend tani, besoj që  
25 ishin dy makina që po vinin në atë kohë.



1 PY. Në rregull. Kush ishte në ato makina? A patë ndokënd

2 tjetër përveç Alush Agushit?

3 PË. Pashë Binak Gashin edhe ai është nga ajo zonë. Dhe

4 persona të tjerë.

5 PY. Në rregull. Njohët ndokënd tjetër?

6 PË. Jo. Jo atje. Nuk më kujtohet kjo gjëja.

7 PY. Faleminderit, z. Kabashi. Çfarë kishte veshur Alush

8 Agushi kur e patë atë?

9 PË. Nuk e mbaj mend. Më duket se kishte uniformë, po nuk e  
10 mbaj mend në fakt.

11 PY. Ishte i armatosur?

12 PË. Pothuajse të gjithë në atë kohë ishin të armatosur.

13 PY. Dhe e njëjta gjë dhe për Binak Gashin?

14 PË. Po.

15 PY. Në rregull, Dëshmitar. Ju a e njihnit Binak Gashin në atë  
16 kohë, pra, në momentin që e keni parë atë?

17 PË. Besoj që po dhe do t'ju jap dhe arsyen përse e them këtë.

18 Sepse nga mënyra sesi ngjante por edhe sa i madh ishte, ishte  
19 pak i rëndë në peshë dhe përpara se të ndodhte kjo unë kisha  
20 kaluar nga vendi i tij --

21 PËRKTHYESJA: Ka ndërprerje.

22 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] -- në fshat

23 dhe ne po shkonim atje për armët, për të marrë armët dhe

24 mendoj se e kam njohur më parë, po nuk jam 100 për qind e

25 sigurt

1 Z. QUICK: [Përkthim]

2 PY. Në rregull. Dëshmitar, ju më duket thatë që po kalonit  
3 andej nga ai, po nuk dëgjuam emrin e fshatit sepse pati  
4 ndërprerje të linjës dhe nuk arritëm ta kapnim dot.

5 PË. Vendi ku ai po shërbente quhej një fshat Sferka. Aty ka  
6 një shkollë dhe aty ishte vendosur UÇK-ja në atë kohë.

7 PY. E kuptova. Dhe kur keni kaluar në këtë fshat Sferka?

8 PË. Datat nuk i mbaj mend.

9 PY. Pasi keni qenë në malet e Berishës?

10 PË. Nuk e mbaj mend saktësisht se kur. Në fakt, po, sepse kur  
11 kemi vajtur në mal, kemi qenë me njësinë Mala. Dhe kemi  
12 ndejtur rreth një javë apo dy javë. Dhe në kthim po kalonim në  
13 Jabllanicë sepse edhe Jabllanica ishte sulmuar. Dhe ne ndaluam  
14 në Sferkë. Dhe aty u takova me Leopardin dhe ai më tha që i  
15 kishte ardhur fjalë nga Drenica dhe nga baza kryesore që duhej  
16 të shkonte në Shqipëri për armë dhe "Të vinim me shpejtësi  
17 sepse ishim sulmuar". Dhe më kërkoi që t'i bashkohesha atij  
18 dhe meqë unë kisha përvojë më parë dhe ishte e rrezikshme  
19 situata. Sepse zona kontrollohej nga serbët, ne duhet të  
20 shkonim me makinë. Dhe ka qenë 100 për qind mbasi jam kthyer  
21 nga malet e Berishës.

22 PY. E kuptova. Pra, ka qenë gjatë këtij udhëtimi për në  
23 Sferkë që ju jeni takuar me Binak Gashin. Jam i saktë në këtë  
24 them?

25 PË. Po.

- 1 PY. Okej. Po në atë kohë ju e dinit kush ishte Fadil Gashi?
- 2 PË. Jo, shumë. Njihja ose kisha njohuri për familjen e tij.
- 3 Po nuk e njihja personalisht. Jo shumë.
- 4 PY. Në atë kohë, ju e dinit nga ishte Fadil Gashi?
- 5 PË. Po.
- 6 PY. Po Dine Berishën e njihnit në atë kohë kur morët këtë
- 7 urdhër?
- 8 PË. Po, po.
- 9 PY. Okej. Tani t'i kthehemi asaj çështjeje që po diskutonim.
- 10 Kur patë Alush Agushin dhe Binak Gashin në kryqëzim aty tek
- 11 lumi, çfarë ju tha specifikisht Alush Agushi juve?
- 12 PË. Unë e thashë, në fakt, pak më parë. Nuk është e mbaj mend
- 13 fjalë për fjalë çfarë më tha.
- 14 PY. Përpara që juve thatë që kur tha që duhet të kujdeseshe
- 15 për Fadil Gashin, është e saktë??
- 16 PË. Po.
- 17 PY. A ju thanë ndonjë gjë tjetër?
- 18 PË. Këtë nuk e mbaj mend se çfarë folëm.
- 19 PY. Ishte ndokush tjetër i pranishëm kur ju tha juve Alush
- 20 Agushi që të kujdeseshit për Fadil Gashin?
- 21 PË. Jo. Jo. Një nga kushërinjtë e mi.
- 22 PY. Një nga kushërinjtë e juaj -- ju lutem vazhdoni.
- 23 PË. Jo. Nuk e mbaj mend. Ai ishte i pranishëm.
- 24 PY. Po pasi u dha urdhri? Pasi ua dha urdhrin çfarë bëri
- 25 Alush Agushi?

1 PË. Unë vajta në rrugën time. Ai vazhdoi rrugën e vet.

2 PY. Dhe pasi u largua a informuat ju personat e tjerë që  
3 ishin me ju?

4 PË. U përpoqa që t'i dërgoja fjalë të dyve. T'i dërgoja fjalë  
5 Fadil Gashit dhe Din Berishës.

6 PY. Dhe si e bëtë këtë gjë?

7 PË. Din Berisha kishte një kushëri që ishte në të njëjtin  
8 fshat.

9 PY. Okej. Dhe si mendonit që do t'ia dërgonit atyre mesazhin?

10 PË. Në atë kohë kur filluan të ndodhnin këto gjëra, në  
11 përgjithësi askujt nuk i pëlqente kjo gjë sepse nuk ishte  
12 diçka që ne duhet ta bënim. Dhe unë u përpoqa që të bëja më të  
13 mirën e mundshme për të ndaluar dhe u përpoqa që të shpëtoja.  
14 Kështu që u përpoqa t'i dërgoja fjalë nëpërmjet kushëririt tim  
15 që ai të bënte kujdes.

16 PY. Okej. Kur ndaluat në këtë kryqëzim afër lumit dhe folët  
17 me Alush Agushin, kushëriri ishte me ju? Kush ishte tjetër me  
18 ju?

19 PË. Kisha dy kushërinj të mitë me mua në makinë.

20 PY. Kishit dy kushërinj? Po ndokush tjetër ishte?

21 PË. Nuk e mbaj mend sa ishin. E di që kushëriri im i parë  
22 ishte se kemi shkuar në luftë bashkë. U kyçëm bashkë. Dhe ai  
23 ka qenë me mua pothuajse gjithë kohës. Të tjerët --

24 PËRKTHYESJA: Nuk dëgjohet, ka ndërprerje.

25 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] -- të tjerët

1 -- unë u përpoqa që ta ndihmoja atë.

2 Z. QUICK: [Përkthim]

3 PY. Dhe ju sapo dëshmuat që një prej kushërinjve tuaj u  
4 përpoqët që me anën e tij t'i çonit një paralajmërim Fadil  
5 Gashit. Ju e dini nëse ia ka çuar ai atë mesazh?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar.

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk jemi të qartë se kush e mori  
8 mesazhin Fadil Gashi apo Din Berisha?

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

10 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Din Berisha.

11 Z. QUICK: [Përkthim]

12 PY. Juve sapo thatë Din Berisha. Ky ishte personi të cilit  
13 donit t'ia dërgonit mesazhin dhe a e mori ai mesazhin?

14 PË. Me ç'di unë, besoj që po, sepse ai edhe u largua nga  
15 Kosova menjëherë dhe vajti në Austri me ç'di unë menjëherë.

16 PY. Në rregull. Pasi u larguat nga kryqëzimi, pasi folët me  
17 Alush Agushin, ku vajtët?

18 PË. Në fakt, vajta tek kushërinjtë e mi, siç thashë dhe më  
19 pas nuk e mbaj mend, ka qenë e njëjta ditë. Nuk e mbaj mend

20 PY. Në rregull. Dhe mbasi vajtët në Volljakë tek kushërinjtë  
21 tuaj, vajtët gjëkundi tjetër?

22 PË. Siç e thashë nuk e mbaj mend. Zakonisht shkoja në  
23 Jabllanicë ose shkoja në Drenicë për armë. Po atë ditë nuk e  
24 mbaj mend se ku kam vajtur.

25 PY. Okej. A e mbani mend se kur ishte hera tjetër që vajtët

1 në Jabllanicë, sepse ju thatë që zakonisht shkoja në

2 Jabllanicë më pas?

3 PË. Sapo e dhashë përgjigjen. Sapo jua dhashë përgjigjen për  
4 këtë. Nuk e mbaj mend. Ndoshta atë ditë jam kthyer.

5 PY. Okej. Atëherë --

6 PË. U ktheva atë ditë. Mund të ketë qenë atë ditë.

7 PY. Atëherë shumë shpejt pas asaj, kështu po e interpretoj  
8 unë?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ku u kthyet në Jabllanicë, çfarë patë atje?

11 PË. Për çfarë e keni fjalën? Çfarë do të thoni?

12 PY. Kur u kthyet në Jabllanicë kur vajtët në fshat?

13 PË. Në një bazë ku shkoja gjatë gjithë kohës.

14 PY. Dhe kjo bazë ishte bazë e UÇK-së?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe kur arritët në këtë bazë, kë patë ose çfarë patë?

17 PË. Ne e kemi bërë këtë diskutim edhe më parë. Dhe ju po  
18 pyesni që çfarë bëtë, çfarë patë atë ditë, unë nuk mbaj mend  
19 çfarë kam parë në të njëjtën ditë. Këtë kanë bërë edhe  
20 prokurorët e tjerë edhe hetuesit e tjerë që janë përpjekur që  
21 të lidhin gjërat me njëra tjetrën. Dhe unë e shoh tani që po  
22 përpiqen që të lidhin gjëra, për shembull, me çfarë kam parë  
23 ose kë kam takuar kur jam kthyer në Jabllanicë.

24 PY. Dëshmitar, unë nuk po përpiqem që të bëj lidhje, thjesht  
25 po ju pyes.

1 PË. Po, po e bëni.

2 PY. Kur u kthyet në Jabllanicë në bazën e UÇK-së, në fshat,  
3 kë patë apo çfarë patë? Ka qenë në të njëjtën ditë apo në  
4 ndonjë ditë tjetër?

5 PË. Së pari mund të ketë qenë e njëjta ditë sepse Jabllanica  
6 ishte vendi im. Vendi ku unë ku kyça në UÇK. Aty, pra, u kyça  
7 në njësinë time. Dhe po të shkojmë në vende tjera për të  
8 ndihmuar apo për të bërë diçka ne do të ktheheshim aty. Dhe  
9 tani a u ktheva atë ditë apo jo? Këtë nuk e di. Unë thjesht  
10 vazhdoj t'ju them të njëjtën gjë. A pashë ndokënd? Më bëni një  
11 pyetje të drejtpërdrejtë kështu do të ishte më mirë ndoshta.  
12 për çfarëdo lloj gjëje. Ju, Gjyqtari apo pala tjetër dhe unë  
13 do t'ju përgjigjem në mënyrë të drejtë dhe të vërtetë.

14 PY. E kuptova, z. Kabashi. A patë ndokënd në Jabllanicë kur  
15 vajtët te baza e UÇK-së?

16 PË. Unë pashë shumë veta, shumë njerëz kur shkova në  
17 Jabllanicë te baza e UÇK-së, shumë vetë.

18 PY. Okej. Dhe herën e parë që vajtët në Jabllanicë më pas,  
19 pasi kishit marrë urdhrin nga Alush Agushi, kë patë tek baza e  
20 UÇK-së në fshatin Jabllanicë?

21 PË. Nuk e mbaj mend. Mund të më ndihmoni meqenëse dëshironit  
22 që ta dinit këtë gjë, ju lutem.

23 PY. Ne folëm më parë për Alush Agushin. A e patë Alush  
24 Agushin tek baza e UÇK-së në fshatin Jabllanicë?

25 PË. Po.

1 PY. A patë ndokënd tjetër, a mbani mend të keni parë ndokënd  
2 tjetër?

3 PË. Njerëz që i mbaj mend?

4 PY. Po, ashtu është.

5 PË. Unë kam parë shumë vetë.

6 PY. A njihje ndonjërin prej tyre, për shembull, përveç Alush  
7 Agushit, ne kemi folur edhe për Binak Gashin. A e patë atë tek  
8 baza e UÇK-së në Jabllanicë pas kthimit tuaj?

9 PË. Nuk mbaj mend që Binak Gashi të ketë qenë i kthyer në atë  
10 moment. Nuk e mbaj mend. Ndoshta dhe ishte kthyer, po nuk e  
11 mbaj mend. Ndoshta jo.

12 PY. Në rregull. Në kohën kur u kthyet në Jabllanicë në bazën  
13 e UÇK-së në fshat, çfarë uniforme kishit veshur?

14 PË. Pasi vajta për armë në Sferkë, siç e përmenda, kisha  
15 veshur një uniformë të zezë dhe atë e përdorja goxha që ishte  
16 nga zona.

17 PY. Dhe a keni bërë ndonjë bisedë për uniformën e zezë me  
18 ndokënd kur u kthyet në Jabllanicë në bazën e UÇK-së?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe me kë e keni bërë këtë bisedë, kush ishte ky person?

21 PË. Ka qenë Rexhep Selimi. Ai ishte me të tjerë në Jabllanicë  
22 në oborrin e përparmë të bazës. Ai e njohte uniformën,  
23 uniforma që u përket Tigrave të Zinj një njësi që ishte  
24 krijuar në Drenicë. Dhe ai më tha që kjo uniformë i përket  
25 dikujt tjetër dhe tha, "Do t'i marr". Dhe kur i shpjegova se



1 kush jam edhe kush ma kishte dhënë, tha "Ah, e kuptoj dhe e  
2 di".

3 PY. Faleminderit, z. Kabashi.

4 PËRKTHYESJA: [Përkthim] Përgjigjja nuk dëgjohet.

5 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] -- atë ditë.

6 Z. QUICK: [Përkthim]

7 PY. Më falni, z. Kabashi se nuk ju dëgjuam dot në pjesën e  
8 caktuar të fjalisë nëse mund ta përsërisni?

9 PË. Po, thashë po, që e takova Rexhep Selimin atë ditë dhe  
10 bëmë bisedë për uniformën e zezë.

11 PY. Në rregull. Faleminderit, z. Kabashi. Në atë kohë, a e  
12 njihnit Rexhep Selimi ju?

13 PË. Ne e njihnim atë si Dhjetëshin. Por edhe një herë tjetër,  
14 nuk e di, më duket ka qenë më përpara, këtë herë për të cilën  
15 po flasim. Ne kishit arrit na kishin marrë me makinë dhe po  
16 shkonim në Drenicë me të tjerë për armë dhe isha bashkë me të  
17 në makinë dhe vajtëm në Jabllanicë së bashku.

18 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani në Jabllanicë ju keni  
19 thënë që patë Alush Agushin, Dine Berishën, Rexhep Selimin. A  
20 takuat ose patë ndokënd tjetër që e njohët?

21 PË. Jo, nuk e përmenda Dine Berishën.

22 PY. Ndjesë. Binak Berishën. Ishte gabimi im. Binak Berishën,  
23 Alush Agashin dhe Rexhep Selimin?

24 PË. Binak Berishën thashë që e takova tek lumi. Nuk mbaj mend  
25 ta kem parë në Jabllanicë. Mbjaj mend që kam parë Rexhep

1 Selimin dhe kemi patur një bisedë. dhe mbaj mend që ka patur  
2 edhe persona të tjerë me të në Jabllanicë po ata nuk i njihja.  
3 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A e ekzekutuar ju urdhrin për  
4 të vrarë Fadil Gashin?

5 PË. Jo, nuk e bëra.

6 PY. Dhe pse jo?

7 PË. Siç e thashë edhe më parë, për mua, jam rritur si  
8 shqiptar dhe ne nuk bëjmë këtë gjë, nuk e bëjmë këtë gjë. Nuk  
9 vrasim njëri-tjetrin se kemi besime të ndryshme. Pa urdhër  
10 Gjykate, pa drejtësi, të vrasës dikë thjesht se ai ka mendim  
11 ndryshe dhe kjo po ndodhte në atë kohë. Kjo ishte ajo që po  
12 ndodhte. Dhe jo thjesht të vrasës tjetrin sepse mendon  
13 ndryshe.

14 PY. Z. Kabashi, ju e ekzekutuat urdhrin për të vrarë Dine  
15 Berishën?

16 PË. Jo.

17 PY. Dhe për të njëjtën arsye?

18 PË. Sigurisht.

19 PY. Më pas a folët ndonjëherë, biseduat ndonjëherë me Alush  
20 Agushin për urdhrin?

21 PË. Mbaj mend që kam patur një bisedë tjetër në lidhje me  
22 këtë çështje sepse, me ç'mbaj mend, menjëherë pasi mora  
23 urdhrin, është një rrugë që lidh Jabllanicën ku unë shërbeja  
24 dhe ku jeton Fadil Gashi. Është një rrugë që shkon nga qyteti  
25 i Klinës për në Gjakovë. Dhe në atë kohë ishte nën kontrollin

1 tonë, por pas ofensivës e morën nën kontroll serbët. Dhe kjo  
2 ishte menjëherë pas kësaj gjëje. Kështu që me ç'mbaj mend edhe  
3 njëherë me ç'mbaj mend, arsyetimi im ishte që nuk mund të  
4 shkoj në atë zonë tani për tani sepse është e rrezikshme dhe  
5 të shohim.

6 PY. Dhe ju ja dhatë këtë arsye Alush Agushit?

7 PË. Po, kjo ishte.

8 PY. Okej. Z. Kabashi, më pas ju a folët i treguar ndokujt  
9 tjetër për urdhrin që kishit marrë për të vrarë Fadil Gashin  
10 dhe Dine Berishën?

11 PË. Pas çfarë? Pas kur?

12 PY. Pasi keni marrë urdhrin, përveç personave të cilët kemi  
13 diskutuar, a ke folur me ndokënd tjetër për urdhrin që kishit  
14 marrë për të vrarë Fadil Gashin dhe Dine Berishën?

15 PË. Në atë kohë, mbaj mend që pas urdhrin të Rrok Berishës që  
16 mu dha, unë u përpoqa që të kuptoja nga po vinin këto dhe pse.  
17 Dhe fola me të me xhaxhain tim, tek i cili kisha besim dhe unë  
18 isha rritur me të, ai kishte përvojën e jetës, ai i kupton  
19 gjërat, njeh njerëz, me familjen kryesisht. Po ai ishte ai  
20 person që i di gjërat dhe që më ndihmonte kur unë kisha  
21 probleme apo kur kisha nevojë, për shembull, për të marrë  
22 vendimet e duhura.

23 Kështu që po, fola me të pasi kisha marrë urdhrin për  
24 Rrok Berishën dhe ne vendosëm që të dërgonim, t'i dërgonim një  
25 letër Ramush Haradinajt dhe të kuptonim prej tij nëse ai e

1 dinte për këto gjëra që po ndodhnin. Por ai nuk na ktheu  
2 përgjigje. Tha që nuk ka njohuri, nuk di gjë për to dhe më  
3 kërkoi që të kthehesha në Jabllanicë, të kyçesha sërish në  
4 ushtri, se ju jeni luftëtarët më të mirë që kam pasur  
5 ndonjëherë. Dhe në atë kohë, ishim katër nga familja ime.

6 Kështu që, por ndërkohë ndodhi dhe një gjë tjetër,  
7 menjëherë pasi erdhi urdhri për Rrok Berishën, ishte Zija Cana  
8 u dha urdhri për ta vrrarë. Dhe komshinjtë e mi dhe ai ishte  
9 kyçur në ushtri pas meje. Ai e kishte urdhrin me njësinë e tij  
10 që ishte njësia Togherit dhe ata nuk e bënë sepse ata e dinin  
11 kush ishte Cana. Që ishte një shqiptar nga Kosova dhe që  
12 ishte, do të thosha, një nga personat patriotë dhe që po  
13 përpiqej që me lëvizjet e tij të bënte gjëra shumë të mira  
14 kundër serbëve, të bashkonte shqiptarët edhe që të falnin  
15 njeri-tjetrin. Të ndihmonin njëri-tjetrin. Pra, me pak fjalë,  
16 ai ishte shumë i njohur për ne.

17 Kështu që nuk e ekzekutonin dot urdhrin, kështu që  
18 vendosën që të lëviznin në një fshat tjetër nga Jabllanica dhe  
19 të dërgonin njerëz tek Ramushi për të folur me Haradinajn për  
20 të folur me të pse po ndodhnin këto gjëra. Dhe ata nuk morën  
21 përgjigjen e duhur dhe në fakt e gjithë njësia u nda. Dhe disa  
22 prej tyre më pas u kthyen në Jabllanicë sepse kur ata nuk e  
23 ekzekutuan urdhrin Togeri po i thoshte, i pyeste kush tha jo  
24 për ta vrrarë. Dhe morën makinën e tij --  
25 PY. Okej. Faleminderit, z. Kabashi. Pra, ju thatë që ju kanë

1 treguar për këtë incident për sa i përket Canës dhe nga një  
2 fqinjë.

3 Kush ishte ky komshi?

4 PË. Kelmendi. Dhe atij i thanë që të fliste me Zekeri Canën  
5 dhe të bisedojë dhe me Adem Demaçin. Ishte një kohë shumë e  
6 keqe për të shkuar nga Peja në Prishtinë. Ishte në fakt një  
7 mision vetëvrasjeje. Ishte shumë e vështirë se duhej të shkoje  
8 në një zonë e cila kontrollohej nga serbët. Xhaxhai ndërmori  
9 rrezikun dhe ai foli me Zekeri Canën, shpjegoi gjithçka. Për  
10 problemin që unë pata, për gjëra të tjera që ne dinim që po  
11 ndodhnin dhe të përpiqeshim që të bënim diçka ndërkohë, se në  
12 atë kohë Adem Demaçi ka qenë zëri politik, të themi, i UÇK-së.  
13 Ai fliste për UÇK-në, s'di si ta quaj t'ju them të drejtën.  
14 Kështu që ne po përpiqeshim që të arrinim të komunikim me  
15 persona më lartë që të kuptonim pse po ndodhnin këto vrasje  
16 ndërmjet nesh.

17 PY. Okej. Faleminderit, z. Kabashi. Po Xhevdet Kelmendi kur  
18 ju tregoi juve dhe xhaxhait tuaj për këtë incident që kishte  
19 të bënte me Zekeri Canën?

20 PË. Në tetor të 1999, kur unë erdha, kur lëviza nga  
21 Jabllanica dhe mu dha urdhri ka qenë besoj tetor. Tetor besoj.  
22 Tetor ose ndoshta fund shtatori kur na u dha urdhri për Rrok  
23 Berishën, kështu që kjo ka qenë edhe hera e parë që jam takuar  
24 --

25 PËRKTHYESJA: Ka ndërprerje të linjës.

1 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] -- dy  
2 kushërinjtë ndërmjet nesh. Dhe ai më i madhi në moshë që është  
3 edhe më i madhi në moshë nuk ishte i kënaqur për këtë gjë. I  
4 thashë që nuk është e vërtetë. Dhe që në atë kohë Arianiti  
5 ishte vrarë në apartamentin e vetë në Prishtinë dhe ishte  
6 pothuajse në të njëjtën ditë që mua mu dha urdhri për Rrok  
7 Berishën.

8 PËRKTHYESJA: Ka ndërprerje të linjës.

9 DËSHMITARI: [Përmet videolidhjes] [Përkthim] Dhe ai tha  
10 "Unë e dija që vinte që këtej...". Dhe ai tha që sonte -- ai  
11 nuk e besonte. Ne nuk jemi këtu me njeri-tjetrin për këtë gjë.  
12 Nuk e besonte dot as ai. Plus që gjëja tjetër është që Ramushi  
13 ka qenë idhull përpara kësaj gjëje. Dhe kur po ndodhnin këto  
14 gjëra dhe ai nuk na ktheu përgjigje për këto vrasje, unë u  
15 përpoqa që --

16 Z. QUICK: [Përkthim]

17 PY. Faleminderit, z. Kabashi. Ndjesë që ju ndërpresë. Në fakt  
18 e kam të vështirë të kuptoj që Xhevdet Kelmendi kur ju tha për  
19 incidentin në lidhje me Zekeria Canën. Nëse ka qenë pasi është  
20 larguar nga UÇK-ja? Tetor 1998? Pra, mbasi ju u larguat nga  
21 UÇK-ja dhe vajtët në shtëpi.

22 PË. Unë nuk u largova nga UÇK-ja. Shkova në shtëpi. U largova  
23 nga Jabllanica u ktheva në shtëpi dhe qëndrova për një natë,  
24 ndërkohë që Xhevdeti ishte fqinji im, ishte komshiu im dhe  
25 qëndruam së bashku në kopsht. Ai jeton pranë meje dhe kur

1 filloj që të afrohej më pranë zonës tonë ose tokës tonë ai tha  
2 "Mendova që ju pashë ju, po nuk e besova". Por më duhet të  
3 them që isha i lumtur që e pashë. Dhe ai na shpjegoi më pas  
4 problemin që kishim. Kështu që të dy shkua në shtëpinë time  
5 dhe, sikurse e thashë më përpara, u munduam që të gjenim një  
6 zgjidhje. Axhën tim e dërguam në Prishtinë. I cili përpoq që  
7 të gjente një zgjidhje këtij problemi.

8 Dhe ne në një farë mënyre ramë dakord që nuk duhet të  
9 shkojmë në Jabllanicë më. Po duhet të jemi të përgatitur që të  
10 shkojmë në Shqipëri sepse ka njësite të tjera të cilat po  
11 mblidhen së bashku për të luftuar dhe atëherë në fakt unë u  
12 arrestova nga Serbia

13 PY. Faleminderit, z. Kabashi. Në çfarë njësite ka qenë  
14 Xhevdet Kelmendi?

15 PË. Në njësitin e Togërit.

16 PY. A e dini si e ka pasë emrin ky njësit?

17 PË. Kam përshtypjen që e ka pasur emrin Shqiponjat e Zeza.

18 PY. Faleminderit. Ku e kishte bazën ky njësit nëse e dini?

19 PË. Në atë kohë ka qenë në Jabllanicë, sepse pas ofensivës në  
20 zonën e Dukagjinit thuajse të gjithë erdhën në Jabllanicë në  
21 atë kohë. Unë kam parë ushtarë në atë kohë të cilët u kthyen  
22 mbas, domethënë, pas ofensivës shkuan në Jabllanicë dhe pastaj  
23 u kyçën pas në UÇK-në sërish.

24 PY. Tani dua që t'i kthehem pak urdhrit që morët për të vrarë  
25 Fadil Gashin dhe Din Berishën. A i keni treguar gjë TPNJ-së

1 lidhur me këtë urdhër Dëshmitar?

2 PË. Çfarë doni të thoni?

3 PY. Kur keni dhënë dëshmi përpara TPNJ-së a i keni treguar

4 Trupit Gjykues lidhur me urdhrin që keni marrë për të vrarë

5 Fadil Gashin dhe Din Berishën?

6 PË. Sigurisht që kam treguar.

7 PY. A keni bërë deklaratatë të tjera përfshirë këtu edhe

8 deklaratatë në publik sa i takon këtij urdhri?

9 PË. Po.

10 PY. Kur i keni bërë këto deklaratatë?

11 PË. Publikisht besoj që i kam bërë në 2019, herën e fundit që  
12 kam qenë në Kosovë.

13 PY. Në rregull. A ju kujtohet se ky e keni dhënë këtë  
14 intervistë? Në çfarë stacioni?

15 PË. E kam dhënë intervistën në T7, kanali televiziv T7,  
16 kështu e quajnë.

17 PY. Në rregull. Pse dhatë këtë deklaratë publike në këtë kohë  
18 lidhur me këtë ngjarje që po diskutojmë?

19 PË. Ne kemi një shprehje në shqip që thonë me nda shapin nga  
20 sheqeri. Çfarë do të thotë që duhet me i nda gjërat. Sepse  
21 edhe gjatë luftës dhe pas luftës duhej që të bëje me dije se  
22 kush ka vrarë dhe mendoja se ishte e nevojshme për publikun  
23 për njerëzit që të kuptonin që UÇK-ja është përdorur për të  
24 bërë gjëra të këqija. Pra, emri i UÇK-së është përdorur për  
25 gjërat e këqija. Por ndërkohë UÇK-ja ishte për njerëzit. Nuk



1 ishte për mite. Nuk ishte për komandantët. Por ishte për t'i  
2 shërbyer njerëzve.

3 PY. Z. Kabashi, a ke diskutuar ndonjëherë këtë çështje me  
4 Fadil Gashin?

5 PË. Kam pasë një bisedë me të një herë në studio televizive,  
6 sepse kam dëgjuar që ka bërë disa deklarata, që Alush Agushi e  
7 ka dhënë atë urdhër që ai më detyrohet mua. Kështu që shkova  
8 dhe bisedova me të, gjithashtu e njihja atë. Sepse axha im e  
9 kishte shok vëllain e tij. Fadil Gashi ishte i LDK-së. Një  
10 partie politike që është krijuar në vitin 1998, 1999 [sipas  
11 përkthimit] nga Rugova. Ka qenë drejtuesi, udhëheqësi për  
12 Klinën në atë kohë. E kam njohur atë vetë dhe kam njohur dhe  
13 familjen e tij. Më herët kam punuar për të.

14 Ndihesha keq se mund të ndodhte diçka edhe pavarësisht në  
15 qoftë se bëhej fjalë Alush Agushin apo për dikënd tjetër.  
16 Kështu që i thasë që "unë do bëj një deklaratë. Pavarësisht  
17 nga fakti që më duhet që të përfundoj në Gjykatë, do dëshmojë.  
18 Nuk ka problem". Domethënë edhe sipas traditës së vjetër  
19 shqiptare do them të vërtetën që njerëzit ta dinë. Por e  
20 thashë që nuk do të doja që të vritesh dikush. Këtë gjë i  
21 thashë.

22 Ai u pajtua me mua dhe në këto biseda ishte e tillë. Që  
23 "Unë do të kontaktoj ty". Unë thashë "Jo, nuk kam një numër  
24 telefoni ose nuk ke ku të më kontaktosh". Megjithatë për ta  
25 prerë shkurt. Pas kësaj, ai dha një deklaratë dhe tha që "Nuk

1 e besoj atë çfarë ka thënë Kabashi dhe nuk i besoj edhe asaj  
2 çfarë është thënë për Alush Agushin". Dhe për një çast, e  
3 harrova --

4 PY. Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres. Por dua t'ju pyes a e  
5 keni raportuar ndonjëherë këtë rast autoriteteve përgjegjëse  
6 të Kosovës?

7 PË. Për çfarë incidenti e keni fjalën?

8 PË. E kam fjalën për urdhrin pretë vrarë Fadil Gashin?

9 PË. Jo, jo, nuk besoj. Kur kam dhënë deklaratat në 2004 në  
10 TPNJ ishte policia e EULEX-it që gjithë e kanë dëgjuar e kanë  
11 ditur se çfarë kam thënë. Por unë kam thënë të vërtetën. Në  
12 kuptimin që kam thënë atë çfarë ka ndodhur.

13 PY. Faleminderit, z. Kabashi. Na thatë që Alush Agushi ju ka  
14 dhënë urdhër për të vrarë Rrok Berishën, Fadil Gashin dhe Din  
15 Berishën. A e dini ju arsyen se pse ju ka zgjedhur juve ai  
16 pikërisht për të ekzekutuar urdhrat e tij ose për të realizuar  
17 këto urdhra?

18 PË. Kur jam kyçur në UÇK, ashtu si edhe shumë njerëz të tjerë  
19 në Kosovë që ishin -- i kishte ardhur në majë të hundës nga  
20 regjimi serb, sepse unë vetë jam rrahur që kur kam qenë fëmi  
21 nga regjimi serb, kur isha në shkollë, kështu që kur u kyça në  
22 UÇK u kyça vullnetarisht. Dëshiroja që të luftoja për UÇK-në.  
23 Nuk e dija farë se çfarë ishte lufta, nuk dija shumë gjëra,  
24 por thjesht e kisha në mendjen time që dëshiroja që të luftoja  
25 dhe këtë bëra.

1 Ndonjëherë ishte e nevojshme që të shkohej dhe të  
2 merreshin armë dhe atyre ju duheshin njerëzit që kishin më  
3 shumë kurajo. Nuk do them që unë isha më i miri. Por unë kam  
4 shkuar kam marrë armë. Dhe njëherë kur Alush Agushi më tha që  
5 ka ca armë nga Drenica që janë rreth e qark shtëpisë time ose  
6 lagjes time po nuk mund t'i sjellë dot askush, kështu që më  
7 kërkoi që "A është e mundur që t'i marrësh ato armë dhe t'i  
8 sjellës? Po që të sigurohesh që nuk do kapet askush". Kështu  
9 ajo ça bëra unë ishte që mora ca anëtarë të familjes dhe ca  
10 shokë të mi në Drenicë dhe shkua i morën armët ia dhamë UÇK-  
11 së.

12 Mendoj që nga gjithë përvoja që kisha në luftë edhe  
13 gjithashtu edhe në Sukën e Semjanit që është një si kodër që  
14 kemi pasur një luftim me serbët, ka qenë një vijë lufte. Kisha  
15 përvojë, kisha eksperiencë edhe aty edhe përvoja të tjera të  
16 kësaj natyre. Isha edhe i afërt me të. Kështu që kur nuk ishte  
17 vetë i pranishëm aty ai ma linte mua përgjegjësinë e njësitit.  
18 Ai kishte besim tek unë dhe besonte që unë do t'i zbatoja  
19 urdhrat e tij pa problem.

20 PY. Në rregull.

21 PY. Megjithatë unë nuk e besoja kurrë që do më jepte një  
22 urdhër të tillë.

23 PY. Ju faleminderit, z. Dëshmitar. Kam edhe dy tema të tjera  
24 të shkurtra për të përfunduar me ju, kështu që besoj që do  
25 përfundoj përpara pushimit.

1 Z. QUICK: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, të nderuar  
2 Gjykatës, mund të lexoj përmbledhjen sipas rregullës 154 ose  
3 jo si ta mendoni të vlefshme.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi 10  
5 minuta mbi kohën deri tani po filluam paksa ngadalë. Kështu që  
6 mund të vazhdoni.

7 Z. QUICK: [Përkthim]

8 PY. Dëshmitar, do kalojmë në një temë tërësisht tjetër,  
9 domethënë, nuk ka të bëjë fare me urdhrat që cekëm deri tani.

10 Dëshmitar, në dëshminë që keni dhënë në çështjen Limaj që  
11 është pranuar si provë për këtë çështje gjyqësore, juve ju  
12 pyetët në hollësi lidhur me ngjarje që kanë ndodhur në  
13 pranverë të vitit 1998 në Jabllanicë. Nuk është se do i cekim  
14 këto tema tani. Megjithatë ka një çështje për të cilën dua  
15 t'ju pyes. Ka të bëjë me tre motra nga Tërpeza. Ju këtë e keni  
16 diskutuar në incidentin me Çelikon në Kleçkë e keni dhënë  
17 dëshminë tuaj edhe në çështjen Limaj.

18 Do lexoj një pjesë të dëshmisë që keni dhënë lidhur me  
19 këta tre vetë dhe pastaj kam disa pyetje që do t'jua bëj  
20 lidhur me këta persona që do t'jua bëj në seancë private në  
21 mënyrë të tillë që të sigurojmë sigurinë e palëve të treta.

22 Z. QUICK: [Përkthim] Fragmenti që do lexoj është marrë  
23 nga dokumenti IT-04-84bis rreshtat 14 deri në 17.

24 PY. Ajo çka thoni ju është kjo:

25 "Atëhere biseda kishte të bënte me këto goça, me këto

1 vajza, sikurse e thashë i kisha thënë atyre që kishte problem  
2 me ta që ata ishin marrë në pyetje. Akuzoheshin se ishin  
3 spiune serbe dhe që akuzoheshin që ishin në marrëdhënie me  
4 serbët”.

5 Z. QUICK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do ju kërkoja  
6 që të kalonim në seancë private për disa pyetje jo për shumë  
7 kohë, për disa minuta.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem  
9 Sekretare e Seancës na kaloni në seancë private.

10 [Seancë private]

11 [Seancë private teksti i fshirë]

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Quick

Faqe 55

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Quick

Faqe 56

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
6 jemi në seancë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe, do  
8 mbarojmë me deklaratën e Prokurorisë pastaj do bëjmë pushimin  
9 dhe pastaj do të mund të filloni ju me kundërpjetet për  
10 dëshmitarin.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

12 Z. QUICK: [Përkthim] Ju faleminderit.

13 Deklarata e dëshmitarit sipas rregullës 154 përbëhet nga  
14 dëshmia e tij në çështjen Limaj dhe të tjerët përpara TPNJ-së  
15 më datë 11 dhe 14 mars 2005.

16 Rreth 9 prillit 1998, dëshmitari shkoi në Jabllanicë për  
17 t'u kyçur me UÇK-në sepse dëshironte të luftonte për popullin  
18 e vetë. Ai nuk u lejua që të kyçej menjëherë. Dëshmitari beson  
19 se UÇK-ja së pari e kontrolloi historikun e tij për t'u  
20 siguruar që nuk ishte bashkëpunëtorë me armikun.

21 Pasi shkoi në Shqipëri për të mbledhur armë dhe pasi mori  
22 pjesë në luftimin në Sermjan, dëshmitari sërish kërkoi që të  
23 kyçej në UÇK, në Jabllanicë. Lahi Brahimaj ra dakord, i dha  
24 një armë dëshmitarit dhe e dërgoi atë në kazermë, e cila  
25 gjendej në fund të fshatit në një kompleks. Lahi Brahimaj që

1   njihej ndryshe si Magjupi ishte komandanti më i lartë i UÇK-së  
2   në Jabllanicë.

3           Dëshmitari së pari ka qenë pjesë e një njësiti që ka qenë  
4   pjesë e kompleksit në kazermën e Jabllanicës. Në korrik të  
5   1998 ai u kyç në njësitin 192 ose njësitet të Malës që  
6   drejtohej nga Alush Agushi që njihej ndryshe me nofkën Mala.  
7   Në njësitin 192, dëshmitari u zhvendos dhe shkoi në vende të  
8   ndryshme, përfshirë këtu dhe në malet e Berishës në fund të  
9   korrikut të 1998. Detyra e tyre ishte që të ndihmonin për  
10  forcat e Fatmir Limajt, që njihet ndryshe si Çeliku.

11           Kur Jabllanica u sulmua, dëshmitari dhe bashkëluftëtarët  
12  e tij u tërhoqën. Në periudhën nga prilli deri në korrik të  
13  1998, dëshmitari pa dhe mësoi për persona të cilën përfshinin  
14  edhe spiunë të pretenduar dhe bashkëpunëtorë të pretenduar të  
15  ndaluar në kompleksin e Jabllanicës. Në Jabllanicë të ndaluar  
16  ishte ndër të tjera Jah Bushati, Pal Krasniqi, të cilët ishin  
17  keqtrajtuar përfshirë gjithashtu edhe Idriz Balajn dhe të  
18  tjerët.

19           Në tetor të 1998, Alush Agushi i dha dëshmitarit urdhër  
20  që të vriste Rrok Berishën që ishte aktivist i LDK-së. Kur u  
21  pyet, Agushi i shpjegoi dëshmitarit që Rrok Berisha ishte  
22  përgjegjës për ofensivën në lugun e Baranit.

23           Dëshmitari nuk e zbatoi urdhrin. Ai informoi Rrok  
24  Berishën për urdhrin dhe u kthye në shtëpi.

25           Në dhjetor të 1998, policia serbe arrestoi dëshmitarin.

1 Ai u ndalua nga autoritet serbe për më tepër sesa tre vjet në  
2 burgun e Pejës, Dubravës, Lipjanit dhe në fund në Nish.

3 Ndërkohë që ishte i ndaluar në burg, dëshmitari është  
4 keqtrajtuar dhe është rrahur në mënyrë të vazhdueshme.

5 Në dëshminë e tij në çështjen Limaj në 2005, dëshmitari  
6 shpjegoi se kërkoi masa mbrojtëse sepse është quajtur tradhtar  
7 dhe se anëtarët e familjes së tij janë kërcënuar.

8 PY. Z. Kabashi, ky është fundi i pyetjeve të mia. Ju  
9 falënderoj shumë që ishit pjesë e kësaj seance sot dhe ju  
10 kërkoi ndjesë për sa i takon vështirësive dhe vonesave me  
11 lidhjen dhe që shkaktuan disa vonesa për dëshminë tuaj sot.  
12 Kaq kisha. Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kabashi,  
14 do bëjmë pushim për 30 minuta, në mënyrë që të mund të pushoni  
15 paksa dhe do të vazhdojmë më tej pas pushimit për dy orë.  
16 Kështu që bëjmë pushimin tani deri në orën 5.30.

17 Znj. Sekretare, mund ta nxirrnin dëshmitarin nga vendi ku  
18 është.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes  
20 videolidhjes]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë  
22 pushim deri në orën 5.30.

23 --- Pauza fillon në orën 16.53

24 --- Seanca rifillon në orën 17.30

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,

1 mund të sillni dëshmitarin.

2 Z. QUICK: [Përkthim] Sa të sillet dëshmitari, vura re se  
3 ka disa deklarata që -- dua t'ju kujtoj të gjithëve urdhrin e  
4 12 majit 2023 për përdorimin e provave lidhur me dëshmitarë të  
5 mbrojtur. Hapi i parë është që të mos identifikohet  
6 dëshmitari, të tregohet transkripti në një mënyrë që të mos  
7 identifikohet. Dhe së fundi, t'i kërkohet Panelit nëse ka  
8 nevojë për ndonjë ndryshim. Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]  
10 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja e  
11 Gjykatës këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asgjë nuk  
13 shkon tamam siç shpresojmë. Ka ndodhur diçka e papritur, nuk  
14 ka të bëjë me njerëzit tanë, dhe në ndërtesën ku ndodhen u  
15 është dashur të evakujmë ndërtesën. Prandaj duhet të presim  
16 derisa të marrim vesh se çfarë po ndodh. Ju faleminderit për  
17 durimin, dhe presim që të mësojmë se si është puna.

18 --- Pauza fillon në orën 17.32

19 --- Seanca rifillon në orën 17.45

20 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,  
22 Dëshmitar, për durimin. A dëgjoni mirë? Dëgjoni mirë?

23 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të  
25 fillojmë me pyetjet e palës tjetër. I pari do të jetë z.

1 Kehoe, Mbrojtësi i z. Thaçi.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Faleminderit.

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Mirëdita z. Kabashi. Unë quhem Gregory Kehoe, dhe  
6 përfaqësoj presidentin Thaçi. Kam disa pyetje për ju për  
7 sqarim nëse mundem.

8 Unë flas ndonjëherë shpejt, në qoftë se nuk më kuptoni,  
9 më thoni dhe do ta sqarojmë.

10 PË. Nuk dëgjoj asgjë. Tani po.

11 PY. Tani dëgjoni?

12 PË. Po, dëgjoj.

13 PY. Po thosha që kur të diskutojmë, nëse nuk kuptoni pyetjen,  
14 ma bëni të qartë, dhe do ta sqaroj nëse nuk e kuptoni.

15 Nëse mund të ndodhë që të ndërpresim njëri-tjetrin, meqë  
16 të dy flasim anglisht, më thoni ta ndërpres sepse nuk dua  
17 t'jua lë përgjysmë atë që thoni.

18 Dëgjuam gjatë përmbledhjes që bëri Prokurori i ZPS-së se  
19 në 9 prill jeni kyçur në UÇK. Dhe besoj që s'keni pasur  
20 përvojë ushtarake, duke qenë 21 vjeç, apo jo?

21 PË. Po, isha 21 vjeç.

22 PY. Edhe përpara se të kyçeshit në UÇK kishit qenë në  
23 Shqipëri për të marrë armë, kështu?

24 PË. Në kohën, në atë kohë. Atëherë kam shkuar.

25 PY. Keni shkuar dhe përpara në Shqipëri, përpara se të

1 kyçeshit në UÇK? Madje keni këmbëngulur që të shkoni në front?

2 PË. Po.

3 PY. Nuk kishit përvojë për të shtënë me armë.

4 PË. Kur shkua në Shqipëri për herë të parë, bëmë ca, një  
5 trajnim.

6 PY. Pasi u kyçët në UÇK, dhe po ju pyes, kjo ka të bëjë me  
7 deklaratën që i keni dhënë TPNJ-së, për strukturën në zonën e  
8 Dukagjinit, kur ishit aty, edhe keni thënë, dhe kjo gjendet në  
9 U16-2361 deri në 2399, paragrafi 65. Thatë, kur folët për  
10 strukturën, se:

11 "Nuk ishte lloji i strukturës vertikale ushtarake. Disa  
12 ushtarë i raportnin drejtpërdrejt Lahi Brahimit, të tjerë  
13 Alush Agushit, të tjerë Ramush Haradinajt, i cili ishte  
14 komandant i përgjithshëm i zonës së Dukagjinit."

15 Kështu ka qenë, zotëri? Që njerëzit u raportnin  
16 komandantëve të ndryshme?

17 PË. Po. Ashtu ishte. Sigurisht kishte boshllëqe dhe njerëzit  
18 dhe përfitonin për interesat e tyre.

19 PY. Kjo është një gjë tjetër që doja ta përmendja. Po do  
20 vijmë dhe aty, por dua të them nuk kishte brigada, no  
21 procedura?

22 PË. Jo, nuk kishte.

23 PY. Në shumë raste askush s'i jepte llogari askujt, kështu?

24 PË. Jo tamam, nuk është se askush nuk i përgjigjej askujt,  
25 por siç thashë ishte një lloj ndërtese ta quajmë -- në qoftë

1 se më bëni një pyetje të drejtpërdrejt do t' i përgjigjem më  
2 mirë.

3 PY. Ju po thoshit se njerëzit angazhoheshin për qëllime,  
4 nevojat personale dhe përdornin UÇK-në si mburojë.

5 PË. Mund ta përsërisni dhe një herë?

6 PY. Njerëzit vepronin në bazë të qëllimeve dhe nevojave të  
7 tyre personale, dhe UÇK-në e përdornin si një mburojë, të  
8 themi.

9 PË. Po, besoj që po.

10 PY. Do t' i kthehemi dhe kësaj mbas pak. Meqë ra fjala, që ta  
11 sqarojmë dhe këtë, ju thatë diçka për LDK-në. Babai juaj ishte  
12 anëtar i LDK-së, kështu?

13 PË. Çfarë doni të thoni me këtë?

14 PY. Ai ishte mbështetës i President Rugovës në atë kohë,  
15 babai?

16 PË. Në çfarë kohë?

17 PY. Në çdo kohë.

18 PË. Që nga 1988 mund të them 99 për qind e shqiptarëve të  
19 Kosovës ishin mbështetës të Rugovës, ideve të tij. E dëgjonin  
20 fjalën e tij dhe ai, si të thuash, na bashkoi të gjithëve për  
21 t' u përpjekur të çliroheshim nga serbët, për të gjetur  
22 alternativën përfundimtare.

23 PY. Familja juaj ishte mbështetëse e Rugovës?

24 PË. Po, thashë të gjithë, jo vetëm familja ime.

25 PY. Kjo nuk ju pengoi që të shkonit në UÇK apo jo?

1 PË. A mund ta përsërisni?

2 PY. Kjo nuk ju pengoi që të kyçeshit në UÇK-?

3 PË. Jo, sigurisht.

4 PY. Do t'ju bëj dhe disa pyetje, dhe më duroni, sepse këto  
5 pyetje do t'i bëj në bazë të mënyrës se si e paraqiti provën  
6 tuaj ZPS-ja. Mënyra se si u paraqit dëshmia juaj është se ju  
7 keni dëshmuar në çështjen Limaj dhe keni thënë që ato që keni  
8 thënë atëherë janë të vërteta. Jeni betuar, kështu?

9 PË. Unë thashë që informacioni që dhashë është i vërtetë, i  
10 gjithë.

11 PY. E kuptoj, keni arsyet tuaja për këtë, por e kuptoni se  
12 thatë diçka të ndryshme në çështjen e Haradinajt, apo jo?

13 PË. Mund të më ndihmoni të sqaroni për se e keni fjalën?

14 PY. Nga sa dëgjuaam nga ZPS-ja, për burgun në Jabllanicës, për  
15 të cilën dëshmuat në çështjen Limaj dhe Haradinaj, ju thatë që  
16 nuk kishte burgje, dhe ishit nën betim, në Jabllanicë, dhe se  
17 ju nuk keni parë asnjë të burgosur. Dhe e kam fjalën për  
18 dokumentin IT-04-04bis [sipas përkthimit] TR32 deri në T412  
19 [sipas përkthimit] faqja 344, 23 deri në 25, dhe pastaj në  
20 T332 deri në T419, faqja 345, deri në 7 dhe 12.

21 Pra, dua që ta sqarojmë. Ajo që thatë nën betim në  
22 çështjen Limaj thatë që është i vërtetë. Ato që thatë në  
23 Haradinaj, çështjen Haradinaj, nuk është e vërtetë? Kështu e  
24 kam kuptuar mirë?

25 PË. Ajo që thashë sot, se dhashë deklaratë dhe se është e



1 vërtetë. Dhe se si hetuesit, prokurorët në këtë rast, e  
2 shprehën në anglisht dhe në shqip, ishte një problem tjetër.  
3 Por nuk e pranova se kishte një burg, dhe këtë e thashë në  
4 çështjen Haradinaj. Që nuk kishte, sepse nuk kishte burg, në  
5 fakt.

6 Nuk kishte qendër paraburgimi për të thënë që kjo pjesë  
7 ishte për të burgosurit, kjo pjesë është, ishte për ushtarët.  
8 PY. Ju i thatë Gjykatës gjithashtu se nuk keni parë të  
9 burgosur aty, është e vërtetë?

10 PË. Mund ta përsërisni?

11 PY. Ju i thatë Gjykatës në çështjen Haradinaj nën betim, se  
12 nuk keni parë të burgosur.

13 PË. Sepse nuk doja të bashkëpunoja me gjykatën në atë kohë.

14 PY. E kuptoj. Kur u thatë atyre, kur nuk donit të  
15 bashkëpunonit me gjykatën --

16 PË. Me prokurorin në fakt.

17 PY. E kuptoj, por dua ta sqarojmë. Pra kur i thatë gjykatës  
18 në çështjen Haradinaj se "S'kishte të burgosur", kjo nuk ishte  
19 e vërtetë, kështu?

20 PË. Mund ta përsërisni dhe një herë?

21 PY. Ju thatë që nuk donit të bashkëpunonit me gjykatën në  
22 çështjen Haradinaj, dhe nën betim i thatë gjykatës se "Nuk kam  
23 parë të burgosur aty", aty domethënë në Jabllanicë. Kjo nuk  
24 ishte e vërtetë, kështu?

25 PË. Se kur përdorni fjalën "burg", e ju e dini ç'do të thotë

1 burg. Në Jabllanicë nuk ishte ky lloj burgu. Pra kryesisht po  
2 ta shikojmë tamam nuk pashë të burgosur. Dyert ishin të  
3 hapura, ata dilnin jashtë. Shpresoj që ta keni kuptuar.

4 PY. Kur mendoni se s'e kuptoj, ma vini në dukje këtë gjë.

5 Në fund, në çështjen Haradinaj, refuzuat të dëshmonit,  
6 dhe u konsideruat dëshmitar që përbuz gjykatën.

7 PË. Po.

8 PY. Një nga arsyet pse u shqetësuar me Prokurorinë është se  
9 nuk intervistuan një person të quajtur Afrim Morina, kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Në fakt, TPNJ-ja e intervistoi këtë Afrim Morinën.

12 PË. Nuk e di nëse e intervistoi apo jo. Por në atë kohë jo,  
13 mendoj.

14 PY. Ju folët në 2023 me z. Morina. Edhe të ka thënë atëherë  
15 që është intervistuar?

16 PË. Nuk e pyeta Afrim Morinën për këtë. Këtë mund t'ju them.

17 Afrim Morina u ndalua -- u përpoq të kyçej në UÇK ai -- dhe  
18 bashkë me Idriz Gucatin. Kur unë u futa në UÇK në Jabllanicë,  
19 ata ishin aty. Dhe ata ishin keqtrajtuar, rrahur kur i pashë.

20 Mund të thonë gjëra të tjera, për shembull Fadil Gashi mund të  
21 thotë "Nuk e besoj këtë apo ajo", por Afrim Morina u rrah,  
22 edhe Idriz Gucati, të dy erdhën për t'u futur në UÇK si puna  
23 ime.

24 PY. Në fakt Afrim Morina i tha TPNJ-së se nuk e kishin  
25 rrahur.

1 PË. Unë e thashë më përpara, nuk do të dëshmojë sepse nuk i  
2 beson TPNJ-së, nuk i beson sistemit sikurse dhe unë nuk i  
3 besoj.

4 PY. Po Afrim Morina e tha që nuk ishte rrahur asnjëherë? Ju  
5 thoni që s'është e vërtetë.

6 PË. Ai mund të thotë çfarë të dojë.

7 PY. Duke refuzuar të dëshmonit në çështjen Haradinaj -- po  
8 jua lexoj. Në intervistën me numër T7, në 2019, thatë që:  
9 "Po të mos isha unë, Ramush Haradinaj do të ishte -- po  
10 të mos isha unë ai do të ishte dënuar, e kishte kryer apo jo  
11 krimin."

12 PË. Nuk e thashë këtë, nuk e thashë këtë.

13 PY. "Po, unë jam protagonist i kryesor që e shpëtoi atë.  
14 Qëllimi ishte të mos shpallej fajtor."

15 Pra në qoftë se ju thoni në intervistën tuaj që ju jeni  
16 arsyeja pse Ramush Haradinaj --

17 PË. Thashë dhe po jua tregoj menjëherë tani arsyen. Arsyeja  
18 është sepse Prokurorët, që nga dita e parë -- unë dhashë  
19 intervistë se doja që të ndaloja krimet. Arsyeja ishte sepse  
20 njerëz të pafajshëm po vriteshin, shqiptarët po vriteshin.

21 Arsyeja, pra thashë, që e thashë, është se Prokurorët nuk  
22 donin t'ia dinin. EULEX-i, për mendimin tim, askush nuk donte  
23 t'ia dinte. Ata donin vetëm që Haradinaj, ishte kryeministër,  
24 ta sillnin aty. Siç kanë bërë dhe tani me z. Thaçi, mund ta  
25 kishin marrë përpara, por e morën kur ishte president, dhe kjo

1 më thotë mua se gjithçka është politike. Sepse i kishin,  
2 kishin prova edhe atëherë, mund ta kishin pyetur Afrim Morinën  
3 dhe të ishin përpjekur ta zbulonin të vërtetën dhe Alush  
4 Agushin mund ta kishin pyetur dhe mund të ishin përpjekur të  
5 mësonin pse ndodhën këto gjëra. Por ata donin thjesht të  
6 paraqisnin emra në gjykatë. Dhe mund t'i thonin Jugosllavisë  
7 ju bëtë krime, edhe kroatët, tani dhe shqiptarët.

8 Prandaj nuk doja të bashkëpunoja me ta, prandaj isha  
9 kundër tyre sepse ata gjithmonë janë përpjekur të luanin me  
10 emra, dhe jo me atë që ndodhi vërtetë.

11 Për shembull, në rastin e Alush Agushit dhe Rrok  
12 Berishës, me atë që ndodhi me ta dhe me mua në këtë rast, ajo  
13 që dija unë s'kishin të bënë me Ramush Haradinajn.

14 Nga përvoja ime, nga lufta, nga UÇK-ja edhe përpara se të  
15 ishte, përpara UÇK-së, është që këto gjërat nuk lidhen ashtu  
16 siç paraqitet.

17 Kjo ishte arsyeja pse unë nuk doja të bashkëpunoja me ta.  
18 Sepse e kam parë se ku po shkonin gjërat.

19 PY. Siç thatë, në intervistë, njerëzit ishin mbrapa, me një  
20 fjalë e kapën Haradinajn sepse ishte komandant, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Bazuar në njohuritë tuaja, lidhur me zonën e Dukagjinit  
23 për të cilën ju pyeti Prokuroria, ju keni, nuk keni ndonjë  
24 indikacion se Haradinaj ishte i përfshirë në ndonjë gjë?

25 PË. Nuk mund të them që është përfshirë apo jo, por mund të

1 them se kur e pyeta, kur i kërkova të më ndihmonte në çështjen  
2 që kisha unë, me Alush Agushin dhe Rrok Berishën, ai nuk më  
3 dha përgjigjen e duhur. Nuk më tha që, mirë se erdhe në UÇK.

4 Pra, ideja është, mendimi im është që në qoftë se je  
5 komandant ke përgjegjësi për ushtarët e tu. Dhe nuk mendoj se  
6 ai u tregua, veptoi, në mënyrën e duhur.

7 PY. Po ai në atë kohë ju tha, kur e ngritët çështjen se nuk  
8 kishte dijeni për këtë?

9 PË. Po, po.

10 PY. Do t'i kthehemi mbas pak. Kur folëm për çështjet që  
11 dolën, në rastin, në çështjen e Fadil Gashit dhe të gjitha ato  
12 çështje që kishin të bënin me zonën e Dukagjinit.

13 PË. Po, shumica e tyre me të kishte të bënte.

14 PY. Dhe kur ju dolët në televizor në 2019, ju i thatë  
15 Prokurorit se ishte hera e parë që flisnit për çështjen e  
16 Fadil Gashit, kështu? Publikisht?

17 PË. Publikisht, po.

18 PY. Dhe para kësaj jeni arrestuar në demonstrata. Për një  
19 armë. Para kësaj --

20 PË. Po, u arrestova për demonstratë. Dhe dosha të thoja një  
21 fjalë, sepse unë isha personi që e kishte përjetuar masakrën e  
22 Dubravës. Dhe ata që më përfaqësonin mua dhe shokët e mi, unë  
23 nuk më pëlqeu mënyra sesi ata kanë vepruar. Dhe unë doja të  
24 thosha diçka, por ata nuk ma dhanë rastin.

25 Më arrestuan dhe, edhe tani që flasim unë kam një urdhër

1 arresti nga Interpoli po të vij në Evropë. Për një armë pa  
2 leje që nuk ka ndodhur ndonjëherë në Kosovë. Që të nxjerrësh  
3 urdhër-arrest për një person që ka një armë. Por ata e bënë në  
4 rastin tim.

5 PY. Do të vijmë dhe aty mbas pak. Por të gjitha këto ndodhin  
6 përpara se ju t'i jepnit këtë intervistë publike lidhur me  
7 Fadil Gashin. Urdhri për të vrarë Fadil Gashin dhe Dine  
8 Berishën, kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Ta shohim njëherë tani këtë. Një takim i rastësishëm në  
11 anën e rrugës, Alush Agushi del nga makina dhe të thotë për  
12 këtë urdhrin e vrasjes që të vrisje Dine Berishën dhe Fadil  
13 Gashin, kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Pastaj, me sa dihet, ju nuk e zbatuat këtë urdhër,  
16 kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Lidhur me dy vetat e përfshirë, ju nuk shkuat asnjëherë  
19 për t'i thënë Fadil Gashit për këtë, kështu?

20 PË. Ç'doni të thoni?

21 PY. Ju nuk shkuat në shtëpinë e tij që t'i thoshit, ndryshe  
22 nga rasti i Rrok Berishës, nuk shkuat për t'i thënë që kam  
23 marrë urdhër për t'ju vrarë. Këtë nuk e bëtë, apo jo?

24 PË. Jo, nuk e bëra.

25 PY. Askush tjetër në familjen tuaj nuk e bëri këtë gjë?

1 PË. I thamë Dine Berishës nëpërmjet një prej kushërinjve të  
2 mi.

3 PY. Të rrimë një çikë këtu. Ju na thatë se Din Berisha ishte  
4 në rrezik, por jo se kishte, nuk i thatë që kishte një urdhër  
5 për ta vrarë, thjesht se ishte në rrezik?

6 PË. Ç'do të thoni "urdhër për ta vrarë", dhe "rrezik"? E  
7 njëjta gjë është po ta shikosh si duhet.

8 PY. Është një koment që ia keni bërë ZPS-së në shënimet që ka  
9 përgatitur ZPS-ja kur ju ka përgatitur për të dhënë dëshmi, në  
10 paragrafin 49:

11 "Ju s'ju kujtohet nëse i thatë atij", fqinjit, "se ai  
12 kishte marrë një urdhër për ta vrarë Dine Berishën".

13 Por ju thatë, i thatë fqinjit, që t'i thoshte Dine  
14 Berishës të kishte kujdes, se ishte në rrezik, kështu ka qenë?

15 PË. Në ato kohë, duhet të keni parasysh kohën pastaj të bëni  
16 këto lloj pyetjesh. Se nuk ishte punë aq e thjeshtë. Këtu në  
17 Gjykatë, është e thjeshtë ke kohë, ju paguheni të gjithë për  
18 këtë punën që bëni, në atë kohë punët ishin ndryshe. Jeta të  
19 ikte për një çast. Ishin kohë shumë të rrezikshme. Atë që  
20 thashë unë ishte e vërtetë.

21 A i thashë "je në rrezik" apo "kam një urdhër"? Jo nuk i  
22 thashë "kam një urdhër për të vrarë", dërgova kushëririn, i  
23 thashë "paralajmëroje", dhe kjo gjë nuk ishte e lehtë ta bëje,  
24 sepse po të dërgosh dikë dhe ta paralajmërosh se rrezikohet me  
25 jetë, dhe po të merret vesh siç që rasti i Rrok Berishësh

1 rrezikohesh vetë, dhe besoj se e dini më mirë se unë këtë gjë.

2 PY. Po përpiqem të sqarojmë disa --

3 PË. Ju nuk po përpiqeni të sqaroni, në fakt po përpiqeni t'i  
4 ngatërroni dhe më tej. Unë jam shumë i qartë për atë që them.

5 PY. Në qoftë se ju besoni se nuk e kam të drejtë atë që them,  
6 z. Kabashi, do t'ju japim rastin të sqaroni.

7 PË. Po ju e bëni qëllimisht. Më bëni pyetje të drejtpërdrejta  
8 dhe ju them të vërtetën. Jam këtu për të vërtetën, për të  
9 thënë të vërtetën.

10 PY. Ju mund të thoni se i keni thënë ZPS-së në 2004 se ia  
11 shpjeguat -- TPNJ-së, se i kishit thënë atyre për urdhrin e  
12 vrasjes së Fadil Gashit, e ke thënë këtë gjë?

13 PË. Mund ta përsërisni?

14 PY. Po e them drejt. Keni dhënë dy deklarata TPNJ-së, një në  
15 2004, një në 2007, dhe asnjëherë nuk i ke thënë Gjykatës  
16 atëherë në këto deklarata se kishit marrë urdhër për ta vrarë  
17 Fadil Gashin nga Alush Kabashin [sipas përkthimit] -- më  
18 falni, nga Alushi për të vrarë Fadil Gashi. Nuk e ke thënë  
19 këtë gjë kurrë përpara.

20 PË. Në 2007 u largova nga Gjykata. Në 2004, nuk mbaj mend  
21 nëse më kanë pyetur për këtë. Por kur dhashë deklaratën time  
22 përpara kësaj, thashë të vërtetën. Nëse është shkruar në  
23 letër, në një mënyrë apo në një tjetër, kjo është një histori  
24 tjetër.

25 PY. Unë po ju them zotëri, në të dyja deklaratat që keni



1 dhënë për Gjykatën, nuk ka asgjë në asnjërën prej tyre lidhur  
2 me urdhrin për të vrarë Fadil Gashin. Dakord? Dhe pra ju i  
3 keni parë ato dokumente, këto deklarata që keni dhënë?

4 PË. Okej.

5 PY. Ju i patë mbasi i rishikuat pra, dhe në asnjërën prej  
6 tyre nuk kishte asgjë për Fadil Gashin.

7 Të vazhdojmë. Pra nuk ka asgjë në deklaratën e 2004, as  
8 të 2007, për TPNJ-në, ku ju të përmendni këtë urdhrin e  
9 vrasjes, qoftë në çështjen Limaj, qoftë në Haradinaj, kështu?

10 PË. Në rregull.

11 PY. Në fund të ditës, asgjë s'i ndodhi Fadil Gashit, kështu?

12 PË. Në rregull.

13 PY. Kjo është e vërtetë, apo jo?

14 PË. Ai është akoma gjallë.

15 PY. Dhe kemi tani situatën e Rrok Berishës ku ju shkuat dhe e  
16 takuat dhe i tregove lidhur me urdhrin për ta vrarë, kështu?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe ai të tha se kishte shkuar në shtabin e Jabllanicës  
19 për të mësuar se si qe puna, kështu?

20 PË. Do ta shpjegoj, sepse kështu "unë i thashë, ti i the",  
21 nuk po na çon gjëkund. Dua të shpjegoj. Kur vjen puna te Rrok  
22 Berisha është paksa ndryshe puna.

23 Unë doja ta ndaloja, të ndaloja vrasjet, problemi që  
24 kishim, ta ndaloja brenda nesh. Nuk mund ta vrisja një njeri  
25 me gjakftohtësi ashtu. Rrok Berisha në atë kohë ishte deputet

1 i LDK-së, edhe ishte përgjegjës nga Tahir Zemaç që ishte  
2 komandant i UÇK-së për zonën e Baranit, apo Lugu i Baranit,  
3 siç e quajnë.

4 Tahir Zemaç kishte një marrëveshje, bëri një marrëveshje  
5 me Ramush Haradinajn për bashkëpunim. Ata po punonin bashkë,  
6 ishte koha kur kishin bërë marrëveshje. Dhe gjërat po  
7 funksiononin më mirë si ushtri, si UÇK dhe unë isha i kënaqur  
8 për këtë.

9 Kur mora urdhrin për Rrok Berishën, doja të përpigësja të  
10 gjeja një mënyrë të mundshme për të kontaktuar komandën e  
11 lartë, që këto gjëra, këto krime, të ndalonin, apo vrasje. Dhe  
12 të mësonin nga vinin, kush jepte urdhrat. Me Rrok Berishën  
13 patëm një bisedë të gjatë. Se pse ndodhnin këto gjëra, nga po  
14 vinte, kush ishte arsyeja, çfarë problemi kishte me kë.

15 Rrok Berisha...

16 PY. Zotëri, mjafton të themi në këtë pikë që kemi Fadil  
17 Gashin, Dine Berishën, dhe Rrok Berishën dhe asnjëri prej  
18 tyre, asgjë s'u ndodhi, s'i ndodhi asnjërit prej tyre, apo jo?

19 PË. Jo.

20 PY. Dhe personi që jua dha juve këtë urdhër, ishte Agushi,  
21 apo jo?

22 PË. Ëhë.

23 PY. Dhe pasi ju refuzuat që ta bënit këtë gjë, me sa dini ju,  
24 Agushi nuk ia dha këtë kontratë dikujt tjetër, apo jo?

25 PË. Nuk e di këtë gjë.

1 PY. Me ç'dini ju, a ia dha dikujt tjetër?

2 PË. Me ç'di unë, nuk e di a ia ka dhënë urdhrin dikujt  
3 tjetër, apo jo.

4 PY. Dhe ju folët pak te pyetjet që ju bënë nga Prokuroria,  
5 edhe për një individ tjetër që quhet Zakaria Cana, dhe që juve  
6 ju tha që Xhevdet Kelmendi, ju tha që kishte urdhër edhe për  
7 vrasjen e tij, por as atij nuk i ndodhi gjë, apo jo?

8 PË. Jo. Atë ditë, siç e thashë, dhe shpjegova edhe më parë,  
9 ushtarët që e morën urdhrin nga Togeri, ata nuk e kryen  
10 urdhrin, nuk e ekzekutuan atë. Dhe prandaj më pas Togeri i  
11 pyeti dhe kështu më tha mua ai qartësisht, ata u larguan nga  
12 njësitë dhe vajtën në një fshat tjetër. U përpoqën që të  
13 kontaktonin Ramushin, u përpoqën çfarëdo përpjekje bënë, ai më  
14 tha e të tjerë.

15 Dhe në fakt një nga banorët atje që po kalonte me makinë  
16 dhe ishte nga fshati i Bardhaniqit, ai e pa Zakaria Canën në  
17 makinën e vet dhe i tha, dhe këto janë fjalë nga Zakaria Cana,  
18 dhe i tha që, dhe e mori nga vendi me makinë, nga vendi ku  
19 ishte ndaluar, dhe i mori dhe makinën.

20 PY. Po zotëri, të gjitha këto urdhra kanë ardhur nga Alush  
21 Agushi dhe askush tjetër, apo jo?

22 PË. Kjo për shembull me Zakaria Cana nuk ishte nga Alush  
23 Agushi.

24 PY. Po, ato të tjerat, të tre të tjerat erdhën nga Alush  
25 Agushi, apo jo?

1 PË. Ëhë.

2 PY. Po më lejoni t'ju bëj këtë pyetje. Dhe ju keni thënë një  
3 nga intervistat tuaja në YouTube, dhe kemi folur për këtë pak  
4 edhe më përpara, që:

5 "Shumë kriminelë që janë fshehur me emra të tjerë dhe  
6 shumë nga gjërat që ata kanë bërë, njerëzit i kanë bërë për  
7 nevojat e tyre personale, për qëllimet e tyre vetjake dhe janë  
8 përpjekur të fshihen pas UÇK-së, pas emrit të saj"

9 Dhe ju vijoni duke thënë që:

10 "Krimet janë kryer jo në emër të UÇK-së, por për nevoja  
11 personale të këtyre personave dhe janë mbuluar me emrin e UÇK-  
12 së."

13 E mbani mend ju që e keni thënë këtë gjë, zotëri?

14 PË. Nga ku ishte kjo?

15 PY. Në një intervistë që në fakt ka dalë në YouTube, është  
16 një intervistë, besoni ose jo, që ju e keni dhënë në YouTube  
17 në, ç' duket, në 25 maj 2022.

18 PË. Ku?

19 PY. Në YouTube, zotëri, ishte një bisedë e regjistruar në  
20 YouTube.

21 Z. QUICK: [Përkthim] Ndoshta Mbrojtja mund të japë edhe  
22 burimin. Ndoshta ka dalë si burim në YouTube.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] 106 --

24 Z. QUICK: [Përkthim] Ka dalë në YouTube, por ka qenë --

25 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Më duhet

1 edhe burimi.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] 106175-OR-TR-ET [sipas përkthimit].

3 Me ç'kuptoje unë ka dalë nga Top Channel.

4 PY. Dhe këtu kemi zbardhjen si në shqip ashtu edhe në

5 anglisht. Dhe lart në krye të faqes ju thoni:

6 "Shumë kriminelë" --

7 Dhe besoj që mund ta lexoni dhe vetë.

8 "... që janë edhe fshehë pas emrave tjerë, ose dhe shumë  
9 gjëra që i kanë bërë njerëz që i kanë bërë për nevoja të tyre  
10 personale, ose qëllimet e tyre personale, janë mundu me u  
11 fshehë edhe pas UÇK-së".

12 Dhe ju vijoni duke thënë:

13 "Kanë kryer krime jo në emër të UÇK-së, janë kryer për  
14 nevoja personale të njerëzve dhe pastaj janë mbulu në emër të  
15 UÇK-së".

16 A e keni thënë këtë zotëri?

17 PË. Po. Po përpiqem të kuptoj të gjithë gjënë që po më thoni,  
18 por nuk ka kuptim. Doja që ta shihja këtë përpara se të pranoj  
19 këto gjëra, sepse mendoj që e kam thënë në shqip, dhe disa  
20 fjalë mund të jenë edhe ndryshe. Por shumica e gjërave që ju  
21 po thoni tani janë të vërteta. Ato i kanë bërë, unë e besoj  
22 këtë gjë.

23 PY. Pra, njerëzit kanë kryer krime për arsye të veta  
24 personale, për nevoja të veta personale, siç jeni shprehur  
25 edhe këtu, apo jo?

1 PË. Po, këto lloj gjërash kanë ndodhur gjithashtu. E dimë  
2 këtë gjë.

3 PY. Dhe ne e dimë, që juve ju është dhënë urdhër nga Alush  
4 Agushi për të vrarë tre persona. Ai vetë ua ka dhënë juve këtë  
5 urdhër. Ju nuk e kryet urdhrin e tij dhe këta persona  
6 vazhdojnë e janë gjallë edhe sot e kësaj dite.

7 PË. Po.

8 PY. Më fal, dhe kur e pyetët Haradinajn për urdhrin që ju dha  
9 për vrasjen e personit, juve thatë që nuk e dinit këtë gjë,  
10 për Rrok Berishën.

11 PË. Okej.

12 PY. Pra pyetja ime për ju është që ishte Alush Agushi që po  
13 jua jepte ju këto urdhra për nevoja të veta personale?

14 PË. Duhet t'ia bëni atij këtë pyetje.

15 PY. Po në fakt pasi ju refuzuat ta kryenit urdhrin dhe urdhri  
16 nuk ka ardhur nga Haradinaj që t'ju thoshte që t'i vrisnit  
17 këta persona?

18 PË. Si thatë, më falni?

19 PY. Por pasi refuzuat, ju, pra, nuk i vratë këta persona,  
20 Fadil Gashi, Din Berishën dhe Rrok Berisha, kur ju dha juve  
21 urdhri për t'i vrarë ata dhe ju nuk e bëtë këtë gjë, ju nuk  
22 morët ndonjë urdhër nga Haradinaj, për shembull, që ishte  
23 komandanti i zonës, që ta kryenit këtë urdhër, apo jo?

24 PË. Jo, nuk më erdhi ky urdhër.

25 PY. Dhe në fakt, për një person si Rrok Berisha ai kishte

1 marrëdhënie shumë të mira me Ramush Haradinajn, apo jo?

2 PË. Po, siç e thatë ju.

3 PY. Atëherë, gjatë gjithë kësaj kohe dhe -- më falni. Nuk ka

4 asnjë pasojë negative ndaj jush që ju refuzoni të kryeni një

5 urdhër që ju jepet? A nuk ishte e qartë për ju në këtë pikë që

6 kjo ishte një përpjekje personale nga Alush Agushi?

7 PË. Nuk mund ta them këtë gjë. Unë mendoj që Alush Agushi

8 kishte arsyet e veta, lidhjet e veta që kishte ai dhe që ka

9 edhe sot e kësaj dite, dhe në rast se më lejoni që ta shpjegoj

10 këtë gjë, mund -- dëshiroj ta shpjegoj këtë dhe çfarë ndjesi

11 kam unë për këtë gjë.

12 Siç e thashë edhe më parë, nga 1988, 1989, Rugova filloi

13 partinë e vet politike, duke u përpjekur që të gjente mënyrat

14 e duhura për t'i bërë njerëzit bashkë për t'i bashkuar e për

15 të marrë lirinë nga Serbia, nga Jugosllavia, dhe që gjërat po

16 përkeqësoheshin në atë kohë, ne e dimë se çfarë ndodhi.

17 Ne kishim grupe, kishim njerëz që nuk ndaluan kurrë në

18 një farë mënyre dhe me armë ose të bëheshin me njëri-tjetrin,

19 si guerile, do të thosha, dhe që të bashkoheshin edhe njerëz

20 të tjerë dhe të luftonin kundër serbëve dhe për ne në atë

21 kohë, e kam fjalën për me ç'kam dëgjuar për atë që po përpiqej

22 të bënte Rugova, nuk ishte koha e duhur për të filluar luftë

23 kundër Serbisë në vitet 1990, në fillim të viteve 1990, sepse

24 ata ishin ende të fuqishëm dhe ne nuk kishim fuqi, pushtet.

25 Dhe në 1997 gjithashtu, në Shqipëri pati një farë lufte civile

1 ndërmjet vetë politikanëve brendapërbrenda Shqipërisë. Dhe ne  
2 nuk është se kishim as mbështetje, prej tyre, si shtet më  
3 vete. Pra, sepse nuk ishte një shtet i fortë. Dhe nuk di si ta  
4 them, por nuk kishte as qeveri të fortë Shqipëria.

5 Dhe kështu në 1998, kur grupet guerilase shqiptare dhe  
6 UÇK-ja pasi u bë UÇK, filluan që të gjuanin kundër forcave  
7 serbe, stacioneve të policisë, Rugova doli me një deklaratë.  
8 Rugova tha që mund të jenë grupe të caktuara ose Serbia që po  
9 përpiqet që të bëjë diçka. Pra, grupe të frustruar dhe siç e  
10 thashë më parë, 99 për qind të gjithë ishin me Rugovën për  
11 këtë gjë, për lirinë.

12 Kur doli UÇK-ja nga gjithë ai frustrim, të gjithë donin  
13 të bëheshin, të kyçeshin në UÇK sidomos e kam fjalën për të  
14 rinjtë, brezin e ri si mua, dhe kjo gjë ndodhi. Menjëherë UÇK-  
15 ja u bë diçka vërtet e madhe. Por, edhe personat që kam  
16 përmendur në pyetjet që më bëtë edhe ju më parë, e përdorën  
17 këtë, e shfrytëzuan këtë mundësi brendapërbrenda UÇK-së, madje  
18 duke thënë që Rugova ishte tradhtar.

19 Për shembull Alush Agushi shkante për shembull në  
20 shtëpinë e dikujt, shifte shtëpinë e shifte fotografinë e  
21 Rugovës në atë shtëpi, domethënë, e shkatërronte shtëpinë,  
22 përdhunonte, pra këto lloj gjërash. Për mua, kjo ishte diçka e  
23 tillë si ata që donin të merrnin pushtet, pra e përdorën UÇK-  
24 në për pushtet, për vete, për qëllimet e tyre, për synimet që  
25 ata kishin. U përpoqën.



1 UÇK-ja ishte ushtria e popullit. Ishte ushtria e Kosovës,  
2 dhe për këtë u kyçën kaq shumë njerëz në të që të luftonin. Që  
3 të kishte një ushtri që të bënte gjërat e duhura. Gjërat e  
4 drejta. Dhe shumë njerëz që e krijuan UÇK-në nuk janë më këtu  
5 me ne. Dhe të tjerë, nëse mund ta them me një fjalë, është si  
6 ata që rrëmbejnë avionët, ata rrëmbyen UÇK-në dhe e përdorën  
7 dhe shfrytëzuan atë për arsyet që kishin ata.

8 PY. Më lejoni që t'ju ndaloj pak këtu, edhe për interes të  
9 kohës që kemi në dispozicion. Pra ideja kryesore që ju po  
10 thoni, të gjithë këta persona, po flasim për Alush Agushin,  
11 Togerin, Kelmendin -- Xhevdet Kelmendin, të gjithë këta  
12 persona që janë në zonën operative të Dukagjinit, dhe nën  
13 komandën e Ramush Haradinajt, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Në përputhje me veprimet që bëhen për hakmarrje  
16 personale, ju keni thënë për ne që çfarë keni menduar vetë që  
17 po bënin njerëzit për hakmarrje personale, dhe folët për  
18 shembull për ato motrat që ishin nga Tërpeza.

19 Dhe ia keni thënë këto TPNJ-së, edhe në diskutimet që  
20 keni patur, për shembull, me një prej këtyre motrave:

21 "Ajo na tha që problemet tona filluan kur vëllai i gruas  
22 së xhaxhait i ishte kërkuar që të ndihmonte për luftën [sipas  
23 përkthimit] dhe kishte refuzuar. Dhe pastaj kur filloi lufta,  
24 ky person u bë anëtar i UÇK-së dhe filloi që t'i ngacmonte  
25 ato."

1 A e mbani mend ta keni thënë këtë gjë?

2 PË. Po, atë më ka thënë ajo.

3 PY. Okej, atëherë --

4 PË. Po, sepse kur ju më pyesni që a mendoni që e vetmja gjë  
5 mund të jetë kjo, se ai i tha asaj "do të ta shkatërroj  
6 jetën".

7 PY. Edhe një herë, z. Kabashi. Bëhet fjalë për një krim  
8 tjetër i cili në përputhje me komentet tuaja nuk u krye në  
9 emër të UÇK-së, por për nevojat personale të dikujt dhe të  
10 mbuluar me emrin e UÇK-së.

11 PË. Në rast se, në rast se -- që prej fillimisht po flasim,  
12 atëherë ky është një shembull perfekt për atë që thashë unë më  
13 parë.

14 PY. Pra jemi dakord me këtë gjë, pajtohemi?

15 PË. Po, në këtë rast, po.

16 PY. Pra, një person që kryen një krim personal dhe përdor  
17 UÇK-në për të mbuluar këtë krim për arsye personale.

18 PË. Po.

19 PY. Më lejoni të bëj një pyetje. Dhe në fakt nuk isha shumë i  
20 qartë për diçka që thatë që prej fillimit, në fillim. Kur ju  
21 keni dhënë dëshmi për vështirësitë që keni pasur me gjykatën,  
22 me Prokurorët, dhe nuk jam fort i sigurt në fakt, dhe në fakt  
23 është në faqen 19, rreshtin 5, të transkriptit të ditës së  
24 sotme, dhe ju thatë:

25 "Thjesht sepse unë nuk bashkëpunova me ata, e kam fjalën

1 pra ashtu siç donin ata, ata u përpoqën të më lëndonin mua  
2 duke dërguar një letër tek emigracioni dhe duke thënë që ai  
3 bashkëpunon për terrorizëm dhe po përpiqet që të vërë bomba në  
4 zyra në Bruksel.”

5 Për çfarë e keni fjalën këtu zotëri?

6 PË. Jo në Bruksel, në Prishtinë. Në Kosovë.

7 PY. Ah, domethënë jo Bruksel, duhet të thoshte Prishtinë  
8 procesverbali?

9 PË. Po, Prishtinë.

10 PY. Po për kë e keni fjalën këtu? Kush ia dërgoi letrën  
11 emigracionit duke thënë që ju po bashkëpunonit me emigracionin  
12 [sipas përkthimit]?

13 PË. Kush e dërgoi letrën, në të vërtetë, saktësisht, nuk e  
14 di. Por ajo që mora unë, dhe në qoftë se dikush do që ta gjejë  
15 përgjigjen e të marrë vesh, natyrisht mund të lidhen me  
16 emigracionin në Amerikë.

17 PY. Më lejoni të sqaroj diçka. Dosjet e SHBA-së për  
18 migracionin janë të mbyllura, kështu që mund të vijojmë që  
19 këtu.

20 PË. Po, janë dosje të mbyllura, por në qoftë se janë çështje  
21 në gjykatë, ju mundët kërkoni dhe ata ju ndihmojnë.

22 PY. Atëherë më thoni se për çfarë e keni fjalën?

23 PË. E kam fjalën që në vitin 2005, u miratua kërkesa ime për  
24 azil. Dhe në 2007 --

25 Z. QUICK: [Përkthim] Më falni që ndërpres, por ndoshta

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 84

1 diskutimet për statusin e emigracionit të dëshmitarit mund t'i  
2 kryejmë në seancë private.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord, ju  
4 lutem të kalojmë në seancë private.

5 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] A mund të  
6 vijoj tani?

7 Z. KEHOE: [Përkthim] Për një sekondë, ju lutem, do t'ju  
8 themi kur të jemi gati.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Page 85

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Page 86

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Page 87

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04448 (Seancë private)  
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Page 88

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
22 jemi në seancë publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë  
24 pyetje, Emmerson?

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam

1 pyetje në emër të Mbrojtjes së z. Veseli.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. Roberts, kur të jeni gati mund të filloni.

4 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

5 Z. ROBERTS: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjes, z. Kabashi. Shpresoj të më dëgjoni mirë. Z.

7 Kabashi, mirëmëngjes.

8 PË. [Mikrofoni çaktivizuar]

9 PY. Nuk mora përkthimin e përgjigjes tuaj.

10 PË. E thashë, mirëmëngjes.

11 PY. Sikurse e tha edhe Gjykatësi, ne po flasim në anglisht të

12 dy. Kështu që do ju kërkoja që të më dëgjoni që të përfundoja

13 unë dhe pastaj të jepni përgjigjet tuaja. Siç e tha dhe kolegu

14 im, z. Kehoe, në qoftë se ka ndonjë pyetje që nuk e kuptoni

15 mirë, ose në qoftë se doni që t'jua shpreh ndryshe pyetjen, ma

16 thoni këtë gjë dhe do ta bëja me kënaqësi.

17 Dua të prezantohem fillimisht, unë quhem Geoff Roberts,

18 unë jam Mbrojtja, jam Mbrojtësi ose Avokati i z. Selimi,

19 kështu që shpresojmë që të mund të përfundojmë sot. Në qoftë

20 se jo, do të vazhdojmë nesër përsëri.

21 Do filloj pyetjet me përvojën tuaj si ushtar i UÇK-së. A

22 është e saktë që ju thoni që jeni kyçur në UÇK në prill 1998,

23 a është e saktë kjo?

24 PË. Po, besoj se po. Në fillim.

25 PY. Ju keni qëndruar atje deri në fund të majit dhe në atë

1 kohë jeni kyçur në njësitin e Alush Agushit, domethënë në  
2 qershor të 1998, sa është e saktë kjo?

3 PË. Mund të ketë qenë kështu.

4 PY. Ju lutem, bëni 3-4 sekonda pauzë, nga momenti që unë bëj  
5 pyetjen dhe pastaj jepni përgjigjen në mënyrë të tillë që të  
6 kapet çdo gjë që thoni për procesverbal. Faleminderit.

7 Ku ka qenë baza juaj kur keni qenë pjesë e njësimit të  
8 Alush Agushit? Ku e kishit bazën si njësit?

9 PË. Çfarë doni të thoni me këtë?

10 PY. Ku e kishit shtabin ju si njësit, ku e kishin bazën?

11 PË. Në fillim fare kur u kyça në UÇK, apo kur u kyça në  
12 njësitin e Alush Agushit?

13 PY. Pyetja është ku e kishit bazën kur ishit pjesëtar i  
14 njësimit të Alush Agushit? Kam përshtypjen që bëhet fjalë nga  
15 qershori i 1998 edhe në vazhdim.

16 PË. Në Jabllanicë. Por nuk më kujtohet në qoftë se jam kyçur  
17 në njësitin e tij në qershor. Mund të ketë qenë kështu.

18 PY. Mendoni se ka qenë më herët apo më vonë se sa kaq?

19 PË. Mund të ketë qenë më vonë se sa ka qenë më herët.

20 Megjithatë, mendoj që ka qenë diku nga qershori. Mund të ketë  
21 qenë qershor.

22 PY. Kur thoni që bazën e keni pasë në Jabllanicë, a doni të  
23 thoni që keni qëndruar aty gjatë gjithë kohës apo do të thotë  
24 që keni shkuar në vende të ndryshme?

25 PË. Kemi shkuar në vende të ndryshme. Kemi qenë edhe në

1 luftime me këtë njësit.

2 PY. Në luftime me njësitin e kujt?

3 PË. Me njësitin e Alush Agushit. Për shembull, kemi qenë në  
4 një luftim në Rasat e Rahovecit.

5 PY. Kur ka ndodhur kjo?

6 PË. Me datë nuk jua them dot. Nuk më kujtohet. Por ka ndodhur  
7 në periudhën e ofensivës së Serbisë në zonën e Llapushnikut  
8 dhe kur kjo zonë kontrollohej nga ne, domethënë kur vihej nga  
9 Rahoveci në Malishevë, në zonën e Malishevës. Mund të ketë  
10 qenë nga fundi i korrikut, diku aty, por nuk jam shumë i  
11 sigurt.

12 PY. Por kryesisht njësiti ku bënit pjesë ju funksiononte në  
13 zonën e Dukagjinit, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. A keni kryer operacione edhe përtej ose jashtë kësaj  
16 zone, domethënë përveç luftimeve ose operacioneve që përmendët  
17 deri tani?

18 PË. Po, një herë kemi shkuar në malet e Berishës. Edhe aty  
19 kemi funksionuar si pjesë e njësitit të Alushit. E shpjegova  
20 edhe më herët sot besoj.

21 PY. Besoj që i thatë kolegut tim, z. Kehoe, që Alush Agushi  
22 kishte si epror z. Haradinaj, apo jo?

23 PË. Nuk mendoj se thashë se i raportonte ose i jepte llogari  
24 Haradinajt, nuk mendoj se e thashë kështu.

25 PY. Çfarë marrëdhënie kishin këta të dy?

1 PË. Nuk di shumë gjëra, nuk e di. Ishte në rregull  
2 marrëdhënia.

3 PY. Çfarë roli kishte njësit i Malës?

4 PË. Çfarë doni të thoni me këtë?

5 PY. Çfarë funksioni kishte njësit i Malës? Domethënë,  
6 njësit i Alush Agushit?

7 PË. Nuk e kuptoj çfarë doni me thënë çfarë roli kishte.

8 PY. Ishte njësit mbështetës, ishte një njësit i një lloji  
9 tjetër, çfarë funksioni, çfarë roli kryente ky njësit?

10 PË. Mund të them në qoftë se nuk gabohe, që Alush Agushi  
11 kishte njerëzit e vet, kishte bashkëfshatarët e vet, njerëz që  
12 vinin nga e njëjta zonë. Ndonjëherë edhe ata vinin dhe  
13 luftonin. Më kujtohet që na fillim kam parë njërin prej këtyre  
14 personave që ishte pjesë e një luftimi një Jabllanicë, ka qenë  
15 herët kur jam kyçur. Dhe, për shembull, mbaj mend që kam  
16 shkuar dhe kam çuar armë në fshatin e tij në një kohë kur  
17 fshati i tij ishte i rrethuar nga forcat e policisë serbe. Në  
18 atë kohë kam qenë në Shqipëri.

19 Kam shkuar shumë herë në Shqipëri, kështu që nuk më  
20 kujtohet ekzaktësisht, mund të ketë qenë qershor-korrik kur  
21 kjo ka ndodhur. Por, kur ata u kthyen, sepse e dogjën të  
22 gjithë fshatin, kur u kthyen në Jabllanicë, pastaj unë shkova  
23 dhe u kyça në njësitin e tij. Puna jonë ishte që të ndihmonim.  
24 Më shumë kishim natyrë ndihmuese në atë që bënim, dhe të  
25 gjithë këtë gjë bënim.

1 PY. Domethënë, me fjalë të tjera bënit, jepnit ndihmë,  
2 ofronit ndihmë? Por si bëhej kjo gjë? Bëhej në mënyrë  
3 joformale, si e merrnit vesh ju që njësitet e tjera kishin  
4 nevojë për ndihmën tuaj?

5 PË. Mund të jap një shembull. Kur shkuam në Malishevë duke u  
6 kthyer nga Rasat e Rahovecit, ishim bashkë të gjithë si një  
7 pjesë e, autokolone, dhe ne ishim së bashku të gjithë dhe pas  
8 Llapushnikut na u tha që mund të sulmohej gjithashtu edhe  
9 Kleçka, që ishte baza e UÇK-së.

10 Kështu që u dërguam atje në mënyrë që të mund të  
11 ndihmonim ushtarët e tjerë kur të sulmonin. Dhe kemi qëndruar  
12 atje mbase për javë të tëra. Nuk është se pati ndonjë luftim,  
13 por thjesht bëmë punën rutinë, bëmë kontrolle për, në punktet  
14 e tona, dhe nuk e di në fakt se si e quani tamam, por kishim  
15 ato pikat tona, kishim stacionet tona. Kishim punktet ku  
16 kontrollonim në qoftë se vinte armiku apo jo, dhe aty bëmë  
17 thjesht kontrollet rutinë. Por nuk është se kemi pasë ndonjë  
18 luftim në atë kohë.

19 PY. [Mikrofoni çaktivizuar] Ju kërkoi ndjesë se fika  
20 mikrofonin. Thjesht juve i konfirmuat kolegut tim, Kehoe, që  
21 nuk kishte ndonjë brigadë apo ndonjë strukturë në këtë kohë,  
22 po flasim për qershor-korrik 1998.

23 PË. Brigadat ishin duke u formuar në atë kohë. Ishin në  
24 proces e sipër. Nuk më kujtohet ekzaktësisht se në çfarë kohe  
25 ka ndodhur kjo. Për shembull, sa i takon brigadës që u krijua

1 në Jabllanicë, mbaj mend që po vija nga Shqipëria dhe ne u  
2 kyçëm në një brigadë, në një brigadë që u quajt Musë Zeneli  
3 [sipas përkthimit], besoj.

4 PY. Në deklaratë e dëshmitarit të TPNJ-së të 2007 --

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe mund të na e paraqesë  
6 Sekretarja në ekran për ta parë, për procesverbal është  
7 dokumenti 00U016-2361 [sipas përkthimit], dua konkretisht të  
8 paraqitet faqja U016-2399.

9 PY. Jepet komenti për Shtabin e Përgjithshëm. Do t'jua lexoj  
10 në mënyrë që të kursejmë kohë. Ju keni thënë si më poshtë:

11 "Me sa e kuptova Shtabi i Përgjithshëm nuk ishte i  
12 mirornagizuar në kohën kur kam qenë në Jabllanicë."

13 Dua që t'ju pyes që të konfirmoni këtë gjë, domethënë,  
14 kështu e keni kuptuar situatën në Jabllanicë?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe deri kur zgjati kjo? Për shembull, kur ju thoni që  
17 jeni në Jabllanicë, a e keni fjalën deri në gusht, shtator,  
18 tetor, apo edhe më vonë gjatë vitit 1998? Për deri kur flisni?

19 PË. Po flasim që nga fillimi dhe më vonë pastaj, sikurse e  
20 thashë më herët, ku ata gradualisht filluan që të  
21 organizoheshin. Por kur sulmonin serbët, ose kur kishte  
22 ofensiva, si për shembull ofensiva e gushtit, se kështu quhej,  
23 apo ajo e shtatorit, ne prapë shpërndaeshim dhe pastaj nuk  
24 ishte shumë e thjeshtë që të rimblidheshim sërish.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Për procesverbal bëhet fjalë për

1 paragrafin 70 të kësaj deklaratë.

2 PY. Për ta kuptuar mirë atë çfarë po thoni, pra kështu i keni  
3 kuptuar ju gjërat si funksionin në terren, hə? Domethënë  
4 kështu i keni kuptuar që kishte mungesë organizimi? Thjesht po  
5 mundohem që të interpretoj ose të kuptoj më saktë atë çfarë po  
6 thoni.

7 PË. Çfarë doni të thoni ka pasë "mungesë organizimi"?

8 PY. I keni thënë TPNJ-së që Shtabi i Përgjithshëm nuk ka qenë  
9 i organizuar kur keni qenë në Jabllanicë. Dua që të kuptoj, se  
10 pse e keni bërë këtë deklaratë. Ndërkohë që keni -- dhe pasi  
11 kemi diskutuar aktivitete të mëhershme si pjesë e njësitit të  
12 z. Agushaj [sipas përkthimit], domethënë pjesëmarrjes suaj në  
13 njësitin e z. Agushaj, dua ta kuptoj pak më mirë këtë  
14 deklaratë tuajën.

15 PË. Nuk më kujtohet kjo. Nuk e di se ku doni të dilni me këtë  
16 pyetje.

17 PY. Do ta bëj ndryshe pyetjen. Në deklaratën që i keni dhënë  
18 TPNJ-së në 2007, diskutoni për Shtabin e Përgjithshëm. Për të  
19 qenë të qartë, e keni fjalën për Shtabin e Përgjithshëm të  
20 UÇK-së apo e keni fjalën për ndonjë shtab tjetër të  
21 përgjithshëm?

22 PË. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së, e mbaj mend një herë kur  
23 erdhën nga Shtabi i Përgjithshëm nga Drenica. Rexhep Selimi ka  
24 qenë pjesë e tij.

25 PY. Për të qenë i qartë, domethënë në deklaratën tuaj e keni



1 fjalën për Shtabin e Përgjithshëm, domethënë kur thoni Shtabi  
2 i Përgjithshëm e keni fjalë për Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-  
3 së, dhe kur thoni që nuk ka qenë shumë i organizuar,  
4 domethënë, më thoni diçka më tepër për ta kuptuar. Si ta  
5 kuptoj këtë koment tuajin?

6 PË. Një zonë mund të jetë shumë e organizuar. Por nuk ishte  
7 ky rasti. E kam fjalën për Shtabin e Përgjithshëm, e kam  
8 fjalën për zonën ku punonim ne, ku funksionim ne, dhe këto  
9 janë dy gjëra të ndryshme.

10 PY. A po thua që në zonën ku keni punuar juve, Shtabi i  
11 Përgjithshëm nuk ka qenë i mirë-organizuar, këtë po thoni?

12 PË. Po. Në thelb, kjo është. Po përpiqeshim, por sikurse e  
13 thashë dhe më përpara, mund ta shihni dhe vetë sesi i kanë  
14 ngatërruar gjërat, si i kanë bashkuar gjërat pa lidhje me  
15 njëra-tjetrën, dhe nuk mund të bëje dot asgjë lidhur me këtë.

16 PY. Le të kalojmë në një temë tjetër. Tema ka të bëjë me  
17 statusin e personave që mund ose mund të mos jenë ndaluar ose  
18 arrestuar në Jabllanicë në maj dhe qershor të 1998. Keni dhënë  
19 dëshmi në çështjen kundër Limajt në TPNJ më herët. A ju  
20 kujtohet kjo, dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Besoj se i thatë kolegut tim më herët sot, se nuk kishte  
23 burgje në Jabllanicë, sepse nuk kishte burg në Jabllanicë. Se  
24 dyert ishin të hapura. Dhe askush nuk ishte ndaluar. A është e  
25 saktë kjo?

1 PË. Po, e thashë, nuk kishte burg.

2 PY. Kur njerëzit mbaheshin aty, ata kishin mundësi që të  
3 vinin vërdallë aty tek ajo zona ose tek vendi ku mbaheshin të  
4 ndaluar, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Ku ka qenë kjo? Cili ka qenë vendi?

7 PË. Çfarë doni të thoni me këtë?

8 PY. Ku mbaheshin njerëzit? Se ti thua që kishin mundësi që të  
9 lëviznin, dyert ishin të hapura. Për çfarë e ke fjalën?

10 PË. Për vendin ku kemi qëndruar dhe ne, në të njëjtin vend  
11 kemi qëndruar dhe ne.

12 PY. Cili është ky vend? A mund të na e thoni, për çfarë e  
13 keni fjalën ekzaktësisht? Për kë vend e keni fjalën  
14 ekzaktësisht? Ku keni qëndruar ju?

15 PË. Ishte si një tip shtëpie, si një punë shtëpie. Ishte  
16 thuajse në fund të fshatit kur shkoje në drejtim të  
17 Bardhaniqit, ishte një shtëpi, nuk di si ta them ndryshe.

18 PY. Pra, siç e thatë, këtu qëndronin edhe disa ushtarë,  
19 përfshirë edhe veten tuaj, kështu apo jo?

20 PË. Po. Ishte një lloj baze, një lloj qendre ku qëndronin  
21 ushtarët.

22 PY. A kishte edhe civilë aty?

23 PË. Jo, nuk kishte shumë.

24 PY. A e është e drejtë të thuhet se në atë kohë civilët apo  
25 kushdo tjetër mund të hynte e të dilte prej aty?

1 PË. Jo, jo tamam. Nuk ishte ashtu. Ndoshta nga fshati, disa  
2 nga fshatarët mund të vinin, por jo tamam. Domethënë në qoftë  
3 se njihje dikë nuk mund ta bëje këtë gjë.

4 PY. Në atë kohë kishte mungesa uniformash, domethënë nuk  
5 kishte uniforma të mjaftueshme, në zonën përreth Jabllanicës,  
6 edhe në Jabllanicë, kështu?

7 PË. Ëhë.

8 PY. Do të thuash "po"?

9 PË. Po. Po, kishte. Nuk kishte mjaftueshëm uniforma.

10 PY. Domethënë, edhe në qoftë se ishe ushtar i UÇK-së, jo  
11 domosdoshmërisht kishe një uniformë të veshur, kështu i takon,  
12 apo jo?

13 PË. Me shumë gjasa, ushtarët kishin ca uniforma.

14 PY. Po jo të gjithë kishin uniforma, kështu?

15 PË. Ushtarët që ishin në bazë, ushtari ushtar, se nuk di si  
16 t'jua shpjegoj, njerëz vinin nga zona të ndryshme që të  
17 kyçeshin në UÇK në Jabllanicë. Rekrutoheshin si ushtarë,  
18 shkonin në bazë, dhe në qoftë se ishte ky rasti, ushtari do  
19 kishte uniformë. Ose do kishte diçka që i ngjante uniformës  
20 dhe do kishte dhe emblemën e UÇK-së këtu. Do të t'i jepej dhe  
21 një armë. Nuk e di se për çfarë e keni fjalë se nuk e di se  
22 çfarë informacioni doni të dini, apo të nxirrni prej meje,  
23 kështu që do e vlerësoja në qoftë se mund të ishit më konkret?

24 PY. Po. Emblema vetë ose shenja dalluese nuk ishte e  
25 pranishme, domethënë, u prezantua më vonë apo jo? Është e

- 1 saktë kjo, dëshmitar?
- 2 PË. Në atë kohë ne kishim emblema.
- 3 PY. Që nga fillimi, që nga prilli?
- 4 PË. Po, po. Kur unë u kyça kishim emblema.
- 5 PY. Por jo të gjithë ushtarët kishin emblema, apo jo?
- 6 PË. Jo, jo. Mund të thuhet kjo që jo të gjithë kishin.
- 7 PY. Ju thatë gjithashtu që kur njerëzit arrinin, mbërrinin,  
8 shkonin në bazë dhe jo përnjëherë u jepej një uniformë, këtë  
9 sikur thatë apo jo?
- 10 PË. Në qoftë se kishte uniforma, jua jepnin uniformat, në  
11 qoftë se s'kishte, nuk jua jepnin.
- 12 PY. Pra, mund të ishte ushtar i UÇK-së, por nuk ishte e  
13 domosdoshme të kishte uniformë, apo jo?
- 14 PË. Mund të ishte dhe kështu.
- 15 PY. Sa vetë kishte në kazermën në Jabllanicë?
- 16 PË. Ushtarët që vinin nga zonat e tjera mund të ishin 15, 20,  
17 10, 30, varet. Gjatë ditës kishte më shumë, gjatë natës kishte  
18 më pak. Nuk kishte shumë vend ku të flije, kështu që kishte më  
19 pak gjatë natës.
- 20 PY. Besoj se e keni përmendur dhe në dëshmitë e mëhershme që  
21 ky ishte vendi ku njerëzit kalonin para se të shkonin në  
22 Shqipëri.
- 23 PË. Po.
- 24 PY. Dhe ju vetë keni shkuar disa herë në Shqipëri që të  
25 shkonit të mblidhnit armë, kështu?

1 PË. Po.

2 PY. Hera e parë që keni shkuar në Shqipëri për të marrë armë  
3 ju thatë që keni qenë thujse 100 ushtarë, apo jo?

4 PË. Kemi qenë më tepër se sa 100 ushtarë.

5 PY. Pra, kishte shumë veta që kalonin nga kjo bazë ose nga  
6 kjo shtëpi në Jabllanicë në atë kohë, kështu?

7 PË. Po. Por në kazermë, ose në vendin ku qëndronim ne ishim  
8 vetëm ne ushtarët. I trajnonim ushtarët, bënin stërvitje dhe i  
9 çonim në vende të tjera. Ose, për shembull, ca që qëndronin,  
10 ca qëndronin atje, dhe ca ktheheshin aty.

11 PY. Të kalojmë pak tek vendi ku ndodhej shtabi i zonës. A  
12 kishte një vend, domethënë, vendi i shtabit të zonës ishte në  
13 të njëjtën kazermë apo ishte diku tjetër?

14 PË. Jo, nuk mund të them që ishte në të njëjtin vend te  
15 kazerma. Lahi Brahimaj kishte shtëpinë e vet në mes të fshatit  
16 dhe besoj aty ka qenë shtabi, aty shkonin shokët nga luftimet,  
17 nga, ose nga betejat e tjera.

18 PY. Mund të vazhdoni, se të ndërpreva, të kërkoj ndjesë për  
19 këtë. Sa larg ishte shtëpia e Lahi Brahimajt nga kazerma ku  
20 ishit ju?

21 PË. Ndoshta një milje larg, po nuk jam shumë i sigurt.

22 PY. Domethënë një kilometër, një kilometër e gjysmë?

23 PË. Po, një kilometër, një kilometër e gjysmë pak a shumë.

24 Pra, njëra shtëpi ishte brenda fshatit ndërkohë që shtëpia ku  
25 qëndronim ne ishte në dalje, në skaj të fshatit.

1 PY. Domethënë dikush që ishte në shtëpinë e Lahi Ibrahimit,  
2 nuk e dinte se çfarë ndodhte në kazermë?

3 PË. Sigurisht që jo, por edhe mund të dinin, dhe jo.

4 PY. Por ishin dy vende të ndryshme, dy shtëpi të ndryshme  
5 këto, apo jo?

6 PË. Po, po. Ishin dy vende të ndryshme.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sapo na humbi  
8 lidhja me procesverbalin. Lidhja me kompjuterët.

9 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shpresoj që nuk e kam pasur unë  
10 fajin për këtë.

11 [Vështirësi teknike]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se po  
13 hapet prapë sistemi.

14 Z. ROBERTS: [Përkthim] Më thoni, ju lutem, kur të jemi  
15 gati për të rifilluar në mënyrë të tillë që të ndjekim  
16 transkriptin, që të kemi të shfaqur në ekran transkriptin.

17 PY. Ju kërkoj ndjesë, dëshmitar, sepse sapo m'u rihap  
18 kompjuteri. Ndoshta do jetë mirë të filloj sepse duket sikur  
19 do pak kohë kompjuteri im që të funksionojë siç duhet. Por  
20 sigurisht që do preferoja që ndërkohë që bëja pyetjet, të  
21 punonte edhe transkripti, të mund ta shikoja në ekran.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi dhe ne  
23 të njëjtin problem.

24 Edhe kur të na paraqitet transkripti në ekran, duhet që  
25 të sigurohet personi që merret me transkriptimin që jemi duke

1 reflektuar çdo gjë, kështu që do na duhet të bëjmë pesë deri  
2 në dhjetë minuta pushim përpara se të vazhdojmë me një seancë  
3 tjetër.

4 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes  
5 videolidhjes]

6 --- Pauza fillon në orën 19.00

7 --- Seanca rifillon në orën 19.14

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,  
9 mund të sillni dëshmitarin.

10 [Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na vjen keq,  
12 ju kërkojmë ndjesë për këtë vonesë. Por ju jeni mijëra milje  
13 larg nesh.

14 Vazhdoni z. Robertson [Sipas përkthimit]. Keni edhe 15  
15 minuta.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të --  
17 duhet të mbaroni në orën 19.30.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shpresoj që deri atëherë do të  
19 përfundoj shumicën e pyetjeve, pak do të mbetet.

20 PY. Dhe një herë, përshëndetje, Dëshmitar. Tani dua të  
21 kalojmë tek urdhri për vrasjen e Fadil Gashit, për të cilën  
22 dëshmuat më herët, të dhënë nga z. Agushi.

23 Sa për të qenë të qartë, prova -- dëshmia juaj është që  
24 z. Agushi ua dha këtë urdhër kur doli nga vetura kur po  
25 shkonte në Jabllanicë?

- 1 PË. Po.
- 2 PY. Dhe juve ishit në makinë?
- 3 PË. Po.
- 4 PY. Ku po shkonit? Në të njëjtin drejtim, apo po shkonit në
- 5 Volljak?
- 6 PË. Në drejtim të kundërt.
- 7 PY. Ai nuk e dinte që ju duhet të udhëtonit në atë rrugë, nuk
- 8 e kishit bërë përpara me fjalë?
- 9 PË. Jo.
- 10 PY. Ndodhej rastësisht që pa makinën tuaj që po udhëtonte?
- 11 PË. Kur kalon në atë vend, duhet të ndalosh. E shpjegova më
- 12 përpara. Dhe kur shikon njerëz që i njeh, i përshëndet,
- 13 ndalon, bisedon. Është diçka e zakonshme. Foli, më tërhoqi
- 14 mënjanë. Nuk e di sa herë duhet ta shpjegoj.
- 15 PY. Jo, jo. në rregull. Ideja ishte që nuk e kishit bërë me
- 16 fjalë që do takoheshit. Ndodhi rastësisht që takuat njëri-
- 17 tjetrit, kur ndaluat, siç thatë?
- 18 PË. Po.
- 19 PY. Ju i thatë ZPS-së gjatë seancës përgatitore se nuk jeni i
- 20 sigurt se kur e morët këtë udhëzim nga z. Agushi, kështu ka
- 21 qenë?
- 22 PË. Kur e thashë?
- 23 PY. Thashë që nuk ishit i sigurt se kur ka ndodhur ky takim.
- 24 PË. E keni fjalën për urdhrin konkret?
- 25 PY. Pra, ju nuk ishit i sigurt se kur ndodhi ky takimi me z.



1 Agushi?

2 PË. E mbaj mend. Ai ishte aty.

3 PY. Nuk po e vë në diskutim se ku ndodh. Pyetja është që ju i  
4 thatë ZPS-së -- mbase është më mirë t'ju lexoj nga Shënimi  
5 Përgatitor i saj. Mund të jetë më lehtë.

6 Prokuroria kur bëri seancën përgatitore me ju mbajti  
7 shënim për informacionin që i dhatë. Në paragrafin 49 të këtij  
8 dokumenti thuhet se:

9 "W488 [Sipas përkthimit] nuk është i sigurt me saktësi se  
10 kur e mori urdhrin për vrasjen e Fadil Gashit."

11 Pra kështu i thatë Prokurorisë se nuk e dinit se kur u  
12 dha urdhri?

13 PË. Kur ia kam thënë Prokurorisë këtë?

14 PY. Në 9 tetor 2023. Në seancën përgatitore me Prokurorinë.

15 PË. Mund të jetë gabim, unë s'e mbaj -- mbase s'e mbaj mend  
16 atë moment. Por kështu ka ndodhur.

17 PY. Thjesht dua të di se kur, datën, muajin, ju thoni se ka  
18 ndodhur. Ju e dini muajin?

19 PË. Ky është problemi, nuk e mbaja mend me saktësi datën. Por  
20 vendin e mbaj mend shumë mirë.

21 PY. Doja të dija datën.

22 PË. Datën s'e mbaj mend, s'jam i sigurt.

23 PY. Përpara se sa ju dhanë urdhër për të vrarë Rrok Berishën,  
24 kështu?

25 PË. Po.

1 PY. Por ju nuk e morët një urdhër të tillë më përpara,  
2 kështu?

3 PË. Përpara kujt?

4 PY. Përpara këtij takimi, me z. Agushi. Kur ju dhanë urdhër  
5 për vrasjen e z. Gashi.

6 PË. Jo, nuk kisha marrë ndonjë urdhër më përpara.

7 PY. Pra, ju ndalon rastësisht në rrugë, diskuton me ju dhe ju  
8 thotë --

9 PË. Jo, nuk ishte e rastësishme. E njifnim njëri-tjetrin.

10 PY. Por nuk e kishit me fjalë të takoheshit.

11 PË. Po, por në atë kohë unë kisha marrëdhënie shumë të  
12 ngushtë me ushtarët në Jabllanicë, me të gjithë, jo vetëm me  
13 z. Agushi. Me Lahin, isha në marrëdhënie të mira me të. nuk  
14 është se më, rastësisht më mori, më zgjodhi dhe më tha. Unë  
15 merrja urdhra nga ai dhe për gjëra të tjera, për sjelljen e  
16 armëve e të tjera.

17 PY. Po, po. Por këto janë urdhra të tjera,

18 PË. I kam shpjeguar përpara, zotëri, këto gjëra. Nuk e kuptoj  
19 ku doni të dilni, mbase do të ishte më mirë për të gjithë të  
20 ishit më konkret.

21 PY. Ju na thatë se nuk e dini nëse ishte atë ditë apo të  
22 nesërmen, po e riformuloj. Ju shkuat në Volljak, me kushëririn  
23 tuaj?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe thatë që nuk e dini nëse ishte atë ditë apo të

1 nesërmen që përfunduat në Jabllanicë?

2 PË. Po, nuk jam i sigurt 100 për qind.

3 PY. Dhe aty patë z. Selimi dhe z. Agushi në kazermat e  
4 Jabllanicës me shumë të tjerë. Besoj kështu ka qenë?

5 PË. Po.

6 PY. Ju thatë që z. Selimi ju kërkoi uniformën?

7 PË. Po.

8 PY. Ju pyeti, e pyeti se ishte kureshtar, se si -- si u  
9 zhvillu kjo bisedë?

10 PË. Kur shkova në kazermë, kur hyra në portë, një portë e  
11 vogël, dhe bisedova me kolegët, ushtarët dhe u përshëndeta, të  
12 gjithëve. Është mënyrë tradicionale të përshëndesësh njerëzit.  
13 Dhe ai tha, "O, ku e more atë uniformë?" nuk mund ta them  
14 fjalë për fjalë se si, çfarë më tha, çfarë i thashë. Por i  
15 thashë se e mora nga Leopoli [Sipas përkthimit], dhe ai më tha  
16 që këto janë uniforma të Tigrave të Zinj, që ishte formuar  
17 njësi, që ishte formuar në Drenicë. Dhe mendoj që ai po i  
18 mblidhte. Sepse ishin të shpërndarë në vende të ndryshme. Ai  
19 tha, kujtoj që u kujtua që ma kishte dhënë Leopoli [Sipas  
20 përkthimit] edhe më tha "E kuptoj, e kuptoj."

21 PY. Dhe me kaq mori fund biseda? Pra ju i thatë z. Agushi,  
22 jo.

23 PË. Jo, Leopardi.

24 PY. Dhe kaq mbaroi biseda? Dhe ai nuk të njihte, përpara  
25 kësaj bisede?

1 PË. Me sa mbani mend.

2 PY. Me sa di unë, mbase ka qenë -- më ka njohur kur kam  
3 shkuar në Shqipëri për armë, se udhëtua nga Malisheva në  
4 Jabllanicë me të njëjtën veturë. Nuk e di a ka qenë përpara  
5 apo mbrapa, nuk -- për mua s'ka rëndësi.

6 PË. Në lidhje me akuzën -- e di që z. Kehoe e përmendi më  
7 herët, se kur e përmendët këtë urdhrin për vrasjen e z. Gashi  
8 për herë të parë.

9 Po të shohim Shënimet Përgatitore 2, dhe do ta paraqesim  
10 në ekran, që ta shkoni se çfarë është thënë.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është 114114 [Sipas përkthimit]  
12 deri në 115 [Sipas përkthimit]. 116152.

13 PY. Prisni, ju lutem, pak sekonda sa të shfaqet në ekran.

14 PË. Për çfarë është?

15 PY. Prisni një minutë, është një dokument këtu që po vihet në  
16 ekran. Është procesverbal, informacioni që i ke dhënë  
17 Prokurorisë gjatë seancës përgatitore në datën 9 tetor, pra  
18 rreth gjashtë javë më parë.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] Të kalojmë tek paragrafi 54, në  
20 faqen 116152.

21 PY. Dhe këtu e thoni shumë qartë se ju pyetën se pse s'i ke  
22 raportuar përpara urdhrin e Fadil Gashit.

23 "4448 [Sipas përkthimit] shpjegoi se e kishte informuar  
24 TPNJ-në në 2004, kur kish dhënë deklaratën e tij të parë".

25 E shikoni këtë të shkruar aty?

1 PË. Tani m'u shfaq në ekran. Po cila është pyetja?

2 PY. E mbani mend që i keni thënë Prokurorisë këtë gjë gjatë  
3 seancën përgatitore?

4 PË. Kur?

5 PY. Në 9 tetor 2023. Pesë-gjashtë javë më parë. Kur patët  
6 seancën përgatitore.

7 PË. Po, folëm për këtë gjë.

8 PY. Dhe i thatë Prokurorisë që më përpara nuk i kishit  
9 raportuar -- apo ju pyetën dhe ju thatë shumë qartë se ia  
10 kishit thënë TPNJ-së në 2004.

11 PË. Po, i thashë hetuesve të TPNJ-së.

12 PY. Dhe këta hetues e morën deklaratën tuaj të nënshkruar në  
13 2004?

14 PË. Po.

15 PY. Dhe keni dhënë dy deklarata në 2004 dhe një tjetër në  
16 2007? Dy të parat për gjyqin e Limajt, e treta për Haradinaj?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe e keni përmendur në një nga këto deklarata? Ju thatë  
19 hetuesve që e keni përfshirë incidentin me Rrok Berishën.

20 PË. Është përfshirë në deklaratën time.

21 PY. Por në fakt në asnjë nga këto deklarata nuk përmendet  
22 urdhri për Fadil Gashin?

23 PË. Cila është pyetja?

24 PY. Pyetja është, nuk habiteni që i keni thënë hetuesve të  
25 TPNJ-së për këtë incident, siç e thatë vetë, dhe është një

1 akuzë serioze, e rëndë. Përse nuk e vutë re që kjo nuk është,  
2 ishte përfshirë në deklaratën tuaj kur e nënshkruat?

3 PË. Hetuesit e mëparshëm -- nuk më habit asgjë më.

4 PY. Pra, nuk e përmendët një gjë të tillë në 2011, as në  
5 dëshminë tuaj në 2011. Nuk e përmendët as në 2019, kështu, pra  
6 publikisht, e keni përmendur në 2019. Apo ka ndonjë tjetër?

7 PË. Jua kam thënë hetuesve në 2004, por nuk është e shkruar  
8 gjëkund.

9 PY. Nuk ka procesverbal për këtë gjë, nga --

10 Z. QUICK: [Përkthim] Është bërë pyetje dhe është  
11 përgjigjur, ka marrë përgjigje.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po ai mund ta sqarojë që s'ka  
13 asnjë procesverbal të shkruar.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni të  
15 jap unë vendim për këtë.

16 Dhe mund të vazhdoni pyetjen.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim]

18 PY. Pra, nuk ka asnjë dëshmi të shkruar për këtë.

19 PË. Po ku është, çfarë -- ku doni të dilni? Çfarë doni të  
20 thoni? Që t'ju ndihmoj.

21 PY. Po ju bëj një pyetje. Nuk ka procesverbal të shkruar.

22 PË. [Folës që flasin njëkohësisht]

23 PY. Jua bëra tre herë pyetjen, dëshmitar. Nuk ka asgjë të  
24 shkruar për këtë.

25 Z. QUICK: [Përkthim] Nuk është pyetje që dëshmitari mund

1 t'i përgjigjet.

2 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Tamam, nuk  
3 është pyetje. Çfarë do të mësosh, më bëj pyetje?

4 Z. ROBERTS: [Përkthim]

5 PY. Nuk është -- ua bëra tre herë, po jua bëj dhe një herë të  
6 fundit dhe do t'i japim fund për sot.

7 PË. Cila është pyetja?

8 PY. Nuk ka dëshmi të shkruar, me sa dini për urdhrin e Fadil  
9 Gashit gjatë këtyre 20 viteve nga 1998 dhe 2019, kur e  
10 përmendët për herë të parë në televizion.

11 PË. Në qoftë se nuk ka ndonjë procesverbal të shkruar, nuk  
12 ka. Cili është, cila është diferenca? Në qoftë se nuk ka, nuk  
13 ka. Pajtohem me ju. Po ç'do të thotë kjo?

14 PY. Mund t'i japim fund për sot.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot mbaron  
16 dëshmia juaj. Nesër do të fillojmë përsëri. Do ta vendosim pas  
17 një minuti se kur do të takohemi nesër. Ju lutemi dilni me  
18 Sekretaren jashtë dhe për dy minuta do t'ju njoftojmë se kur  
19 do të fillojmë nesër.

20 Sekretare, mund ta nxirrni dëshmitarin jashtë.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë përmes  
22 videolidhjes]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në  
24 seancë publike.

25 Po mendojmë për nesër që ta përdorim kohën sa më mirë nesër,

1 atë kohë që kemi.

2 Z. Halitjaha, mund t'i themi të vijë në orën 15.00 dhe të  
3 dëshmojë deri në 17.00, dhe në 17.30 të vijë z. Kabashi dhe të  
4 dëshmojë deri në 19.30, apo mund të fillojmë në orën 14.00 me  
5 z. Halitjaha, të bëjmë një pushim gjysmë ore dhe të vazhdojmë  
6 nga 16.30 deri 18.30 me z. Kabashi.

7 Keni ndonjë preferencë për të dy apo mendoni se të dy  
8 idetë nuk janë të mira?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk është ide e mirë sepse fillon me  
10 dëshmitarë, ka gjithë ato informacione për të diskutuar dhe  
11 pastaj të kalosh, të ndryshosh pastaj pistën të shkosh te një  
12 tjetër.

13 Unë mendoj që të mbarojmë me këtë dëshmitar dhe të  
14 fillojmë me dëshmitarin Halitjaha të enjten në mëngjes.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po na duket  
16 se kështu do të humbasim disa orë.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Është vështirë të kalosh nga një  
18 dëshmitar te tjetri. Nuk është punë e lehtë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj, nuk  
20 është situatë e përsosur. Por dua të përdorim kohën që kemi. E  
21 kuptojmë qëndrimin tuaj.

22 Z. Emmerson?

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në qoftë se do të zgjidhja midis  
24 14.00 dhe 15.00, do të preferoja të fillonim në 15.00.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si ju duket



1 ideja për t'i bërë të dy?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë nuk kam pyetje për këtë  
3 dëshmitar, përveçse në qoftë se del ndonjë gjë më vonë. Unë  
4 jam gati, nuk kam problem. Mund të vazhdojmë me të dy  
5 dëshmitarët.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts?

7 Z. Ellis?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Unë gjysmë ore kam për këtë  
9 dëshmitar. Nga përgjigjet që kemi marrë deri tani, është pak e  
10 paparashikueshme sa mund të vazhdojë ky person.

11 Gjithashtu, mund të ketë dhe pyetje nga ju, Trupi  
12 Gjykues, dhe mbas kësaj do të ketë pyetje, mund të ketë pyetje  
13 të tjera.

14 Pra shqetësimi që kam është që ky dëshmitar, e kuptoj që  
15 ky dëshmitar duhet të përfundojë në 19.30 nesër. Nuk ka  
16 mundësi ta marrim përsëri të enjten. Në qoftë se do të, nuk do  
17 të mbaronim. Pra në qoftë se e fillojmë këtë zotëri në 17.30,  
18 të vazhdojmë deri në 19.30, 19.30 nuk mund të tejkalohet. Pra  
19 po e kaluam 19.30 do të kemi problem.

20 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Edhe unë, i kemi mbështetur  
22 pyetjet tona në pyetjet që bëri Prokuroria.

23 Në qoftë se juve si Gjyqtarë do të bënit pyetje, mund të  
24 na duhet më shumë kohë. Për momentin unë nuk kam shumë. Mbase  
25 deri në 15 minuta. Por, duhet që të mendojmë gjatë natës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj. Nuk  
2 dua t'ju lidh me mbas fjalës tuaj, por dua të gjej mënyrën për  
3 ta përdorur sa më mirë kohën.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mbase mbarojmë me këtë dëshmitar  
5 në orën 15.00. Në qoftë se ka kohë mbas kësaj, basi të  
6 mbarojmë mund t'i kërkojmë z. Halitjaha të vijë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është më  
8 mirë, dhe unë këtë po mendoja, që të mbarojmë me këtë  
9 dëshmitar në fillim, dhe pastaj të vazhdojmë me Halitjaha?

10 Nuk e di sa keni, sa kohë ju duhet për të vazhduar me të,  
11 me Halitjaha?

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Besoj dhe dy orë e gjysmë. Mbase  
13 mund ta ul pak vlerësimin.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë  
15 kështu të veprojmë.

16 Jeni dakord të gjithë me këtë? Atëherë do të vazhdojmë me  
17 këtë dëshmitar, duke filluar nga ora 15.00 nesër dhe pas tij  
18 do të vazhdojmë me Halitjahën sa mund të bëjmë në kohën që do  
19 të na mbetet.

20 Faleminderit për komentet e bashkëpunimin tuaj.

21 Përfundojmë këtu deri nesër në orën 15.00

22 --- Seanca mbyllet në orën 19.35

23

24

25